



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.06. 2010

**V E N D I M**

**Nr.1318, datë 14. 06. 2010**

**Për**  
**“Miratimin e Dokumentit me Termat Teknike dhe Komerciale për zbatimin e**  
**“Portabilitetit të Numrit”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku , në mbledhjen e datës 14.06. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, mori në shqyrtim materialet shkresore të paraqitura nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhërin Nr. 557, datë 23.04.2010 “Për ngritjen e grupit të përbashkët të punës për hartimin e Dokumentit me Termat Teknike dhe Komerciale për zbatimin e “Portabilitetit të Numrit””

të përbëra nga:

- Dokumenti “Specifikime teknike për zbatimin e Portabilitetit të Numrit” (**Dokumenti**);
- Relacioni shpjegues mbi projektaktin ” (**Relacioni**);
- Projekt-Vendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485” (**Projektvendimi**).

**B A Z A L I G J O R E:**

1. Neni 87, 88, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);

2. Neni 106 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar (*ligji nr. 8485*);
3. Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar (*ligji nr. 9643*);
4. VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar (*VKM Nr. 1*);
5. Rregullorja “Për portabilitetin e numrit”, miratuar me Vendimin Nr. 1219, datë 07.04.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP (*VKD Nr. 1219*);
6. Rregullorja “Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike”, miratuar me Vendimin Nr. 932, datë 11.08.2009 të Këshillit Drejtues të AKEP (*VKD Nr. 932*);
7. “Plani Kombëtar i Numeracionit” (*PKN*), miratuar me Vendimin Nr. 932, datë 11.08.2009 të Këshillit Drejtues të AKEP;
8. Pika 17 e nenit 21 dhe neni 21/3 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
9. Udhëzimit të Ministrit të Shtetit Për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, drejtuar AKEP-it me shkresë Nr. 1451 Prot., datë 16.04.2010 “Mbi implementimin e portabilitetit të numrit celular në Shqipëri” (*Udhëzimi*);
7. Urdhër Nr. 557, datë 23.04.2010 “Për ngritjen e grupit të përbashkët të punës për hartimin e Dokumentit me Termat Teknike dhe Komerciale për zbatimin e “Portabilitetit të Numrit”” (*Urdhëri Nr. 557*)

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, diskutimeve në mbledhje, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

### **V Ë R E N:**

1. Dokumenti është hartuar nga grupi i punës në zbatim të Urdhërit Nr. 557;
2. Nga pikpamja formale procedurale, dokumenti është trajtuar nga grupi i punës në përputhje me përcaktimet ligjore të parashikuara në legjislacionin për prokurimin publik sipas dispozitave të përcaktuara në pikën 2 dhe 3 të Bazës ligjore të këtij akti administrativ;
3. Nga pikpamja substanciale, dokumenti përmban terma referencë në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, ligjin nr. 9918 lidhur me zbatimin e Portabilitetit të Numrit, si dhe aktet nënligjore dhe administrative normative të përcaktuara në bazën ligjore të mësipërcituar;
4. Projektvendimi është në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në nenin 87, 88, pikën 1 të nenit 114, pikën 1 të nenin 115 të ligjit nr. 9918 dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

## **V E N D O S:**

1. Të miratojë miratojë “Specifikime teknike për zbatimin e Portabilitetit të Numrit”, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. “Specifikime teknike për zbatimin e Portabilitetit të Numrit” të miratuara me këtë vendim, të bëhen pjesë e Dokumentit Standart të tenderit publik që do të kryhet nga AKEP sipas procedurës së prokurimit të përcaktuar në ligjit nr. 9643 dhe VKM NR. 1.
3. Me fondin limit të përcaktuar për këtë qëllim në planin e detajuar të shpenzimeve të AKEP për vitin 2010, të miratuar me VKD Nr. 1218, të fillojë procedura sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin për prokurimin publik, për kryerjen e tenderit për këtë qëllim.
4. Autorizohet Kryetari për kryerjen e procedurës së prokurimit sipas këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R**

**Piro XHIXHO**

## **A N Ë T A R Ë :**

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**



**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

# **SPECIFIKIME TEKNIKE PËR ZBATIMIN E PORTABILITETIT TË NUMRIT**

**Tiranë, Qershor 2010**

#### Historik i dokumentit

Version	Data	Autori	Përshkrim i ndryshimeve
0.1	18.09.2009	AKEP	VKD NR.976, 18.09.2009
0.2	04.05.2010	GRUPI I PUNES	Rikonceptim i kapitujve. Ripunim i kapitujve 1 e 2 të dokumentit bazë.
0.3	12.05.2010	GRUPI I PUNES	Ripunim i kapitujve: Përshkrimi i specifikimeve teknike;Procedura e detajuar e bartjes; Rregulla për DBRC;
0.4	14.05.2010	GRUPI I PUNES	Parametra të cilësisë; Informimi i përdoruesit;
0.5	17.05.2010	GRUPI I PUNES	Trajtuar kostot që shoqërojnë procesin e portabilitetit të numrit
0.6	18.05.2010	GRUPI I PUNES	Formatim; Korrektim i pjesshëm gramatikor
0.7	04.06.2010	GRUPI I PUNES	Rishikim Kapitulli 1, 2 e 4 bazuar në komentet e operatorëve
0.8	7.06.2010	GRUPI I PUNES	Rishikim Kapitulli 3 e 5 bazuar në komentet e operatorëve
0.9	9.06.2010	GRUPI I PUNES	Rishikim Kapitulli 6 e Aneks 1 bazuar në komentet e operatorëve
1.0	11.06.2010	GRUPI I PUNES	Rishikim përfundimtar bazuar në komentet e operatorëve

#### Dokumeta të referuar

Nr	Dokumenti
1	“Rregullorja për portabilitetin e numrit” miratuar me VKD nr.1219, datë 07. 04. 2010 të AKEP
2	“Rregullore për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike”, miratuar me VKD Nr.932, datë 11.08.2009 të AKEP
3	“Plani Kombëtar i Numeracionit” miratuar me VKD Nr.932, datë 11.08.2009 të AKEP
4	Ligji 9918, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”

## PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	5
1.2. Referenca dhe shkurtime.....	5
1.2.1. Referenca .....	5
1.2.2. Shkurtime .....	5
1.3. Standarde dhe rekomandime.....	5
2. Specifikime teknike për zbatimin e portabilitetit të numrit.....	6
2.1. Të dhëna të përgjithshme.....	6
2.2. Detyrimet e operatorëve të rrjeteve dhe shërbimeve telefonike të disponueshëm për publikun për implementimin e portabilitetit të numrit .....	6
2.3. Përshkrim i shërbimit të portabilitetit të numrit .....	6
2.3.1. Portabiliteti i numrave gjeografik (PNG) .....	7
2.3.2. Portabiliteti i numrave të lëvizshëm (PNL).....	8
2.4. Rrugëzimi i thirrjeve.....	9
2.4.1. Të dhëna të përgjithshme .....	9
2.4.2. Metoda e rrugëzimit .....	10
2.5. Kodet e rrugëzimit .....	10
2.5.1. Të përgjithshme .....	10
2.5.2. Struktura e Kodeve të rrugëzimit .....	11
2.6. Shkëmbim informacioni në ndërfaqen administrative .....	11
3. PËRSHKRIM I DETAJUAR I PROCEDURËS PËR MENAXHIMIN E PROCESIT TË BARTJES .....	12
3.1. Të dhëna të përgjithshme.....	12
3.2. Proceset administrimit të lidhura me zbatimin e portabilitetit të numrit.....	12
3.3. Procesi i bartjes.....	12
3.3.1. Vlerësimi i kërkesës për bartje .....	13
3.3.2. Faza e aktivizimit të bartjes .....	16
3.3.3. Nënprocesi i anulimit të kërkesave për bartje .....	18
3.4. Procesi i rikthimit të një numri të bartur tek ODhF. ....	19
3.5. Procesi i ndryshimit të informacionit të rrugëzimit .....	21
3.6. Procesi i sinkronizimit .....	23
3.6.1. Nënprocesi kërkimit .....	23
3.6.2. Nënprocesi i sinkronizimit total ose të pjesshëm.....	23
3.7. Procesi i transferimit të blloqeve të numrave. ....	24
3.8. Procesi i informimit për statusin e sistemit .....	25
3.8.1. Statusi i ndërfaqes të sistemit të portabilitetit të numrit të operatorit.....	25
3.8.2. Statusi DBRC.....	26
3.9. Situata Përrjashtuese .....	27
3.9.1. Situata përjashtuese gjatë fazës së vlerësimit .....	27
3.9.2. Situata përjashtuese gjatë fazës së bartjes .....	27
3.10. Intervalet (afatet) e kryerjes së proceseve administrative të lidhura me zbatimin e portabilitetit të numrit .	28
4. RREGULLAT PËR ORGANIZMIN DHE FUNKSIONIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE REFERENCË E CENTRALIZUAR (DBRC) .....	29
4.1. Të dhëna të përgjithshme.....	29
4.2. Arkitektura e DBRC-së.....	31

4.3. Funkcionet e DBRC-së .....	33
4.3.1. Informatizimi i proceseve për zbatimin e portabilitetit të numrit .....	33
4.3.2. Ruajtja dhe ndryshimi i informacionit të rrugëzimit .....	33
4.3.3. Kushte në lidhje me informacionin e vlefshëm për publikun .....	33
4.3.4. Raportet .....	34
4.4. Aksesimi i DBRC-së.....	34
4.5. Funkcioni i faturimit (billing).....	35
4.6. Monitorimi i funksionimit të DBRC-së .....	35
4.7. Kërkesat për DBRC .....	35
4.7.1. Kërkesat për programet aplikative.....	35
4.7.2. Kërkesa për aksesin e përdoruesve në DBRC.....	35
4.7.3. Kërkesa të sigurisë.....	36
4.7.4. Kërkesat për performancën e DBRC:.....	36
4.7.5. Kërkesat për besueshmërinë dhe disponueshmërinë.....	37
4.7.6. Back-up, rikuperimi dhe rikuperimi pas një fatkeqësie.....	37
4.7.8. Modulet e testimit .....	37
4.7.9. Monitorimi i funksionimit të sistemit.....	37
4.7.10. Rritja e kapaciteteve dhe rinovimi (Scalability & Upgrading).....	38
4.7.11. Mirëmbajtja, trajnimi dhe asistencë teknike .....	38
4.8. Roli i OfDBRC-së.....	39
4.9. Te drejtat e OfDBRC-së .....	39
4.9.1. Regjistrimi/ndryshimi/anullimi i regjistrimit të përdoruesit .....	39
4.9.2. Sigurimi i funksionimit të vazhdueshëm të DBRC-së.....	40
4.9.3. Mbështetja administrative e nevojshme për operimin e DBRC-së .....	40
4.9.4. Siguria.....	41
4.9.5. Konfidencialiteti .....	41
4.9.6. Dispozitat për shërbimet e ofruara nga OfDBRC për përdoruesit.....	41
5. PARAMETRAT E CILËSË PËR DHËNIEN E SHËRBIMIT TË PORTABILITETIT TË NUMRIT.....	42
5.1. Të përgjithshme .....	42
5.2. Përkufizimi i parametrave të cilësisë .....	42
5.2.1. Parametrat e cilësisë të procesit të bartjes.....	42
5.2.3. Parametrat e cilësisë të DBRC .....	44
5.3. Objektivat për cilësinë e proceseve të bartjes dhe operatorët përgjegjës.....	44
5.4. Metoda matëse.....	45
6. METODAT E INFORMIMIT TË PËRDORUESIT .....	45
6.1. Përshkrim.....	45
6.2. Informimi i pajtimtarëve për procesin e bartjes të numrit.....	46
6.3. Informimi i përdoruesve në tarifat e ndryshuara për thirrjet tek numrat e bartur.....	46
ANEKS 1.....	48
LISTA E RAPORTEVE STANDARDE.....	48
1) Raporte statistikore.....	48
2) Raportet e ecurisë së procesit të bartjes .....	48
3) Raporte mbi funksionimin e DBRC, lidhur me.....	48
4) Raporte në lidhje me detektimin e përpjekjeve për akses të paautorizuar.....	48

## 1. HYRJE

Ky dokument përcakton specifikimet teknike për procesin e portabilitetit të përcaktuara në Rregulloren për Portabilitetin e Numrit miratuar me VKD Nr. 1219, datë 07.04.2010.

Me qëllim që të zbatohet Portabiliteti i Numrit, operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve telefonike të disponueshëm për publikun duhet të marrin masa specifike me natyrë teknike, operacionale dhe administrative.

Specifikimet teknike për zbatimin e Portabilitetit të numrit duhet të aplikohen nga operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve telefonike të disponueshëm për publikun të cilat kanë detyrimin të sigurojnë portabilitetin e numrit gjeografik ose jo-gjeografik për pajtimtarët e tyre.

## 1.2. REFERENCA DHE SHKURTIME

### 1.2.1. REFERENCA

Këto specifikime teknike i referohen dokumentave të mëposhtëm:

- a. Rregullore për Portabilitetin (RPN) – “Rregullorja për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me Vendimin Nr.1219, datë 07. 04. 2010 të AKEP.
- b. Rregullore e Numeracionit – “Rregullore për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike”.
- c. Plani kombëtar i numeracionit – miratuar me Vendimin Nr.932, datë 11.08.2009 të AKEP.

### 1.2.2. SHKURTIME

Më poshtë jepen disa nga shkurtime që janë përdorur për specifikimet teknike:

1. ACQ – Kërkimi për çdo thirrje (All Call Query)
2. AI – Autorizim Individual
3. AIPN – Autorizimi Individual për përdorimin e numrave
4. DBLP – Baza e të dhënave lokale pasqyrë
5. DBRC - baza e të dhënave referencë e centralizuar
6. DBROp – Baza e të dhënave referencë e operatorit
7. DN - Numri direktorisë (Directory Number)
8. HLR – Regjistri i vendndodhjes së pajtimtarëve të operatorit (Home Location Register)
9. IAM - Mesazhi i adresës fillestare (Initial Address Message)
10. MMS - Shërbimi i mesazhit multimedial (Multimedia Message Service)
11. MSISDN - Mobile Subscriber Integrated Services Digital Network Number
12. NP - Portabiliteti i Numrit (Number Portability)
13. CdPN - Numri i pajtimtarit të thirrur
14. NR - Kodi i rrugëzimit
15. ODh - Operatori dhënës
16. ODhF -Operatori dhënës fillestar
17. OfDBRC - Ofruesi i bazës së të dhënave referencë centralizuar
18. OM - Operatori marrës
19. OOTh – Operatori i origjinimit të thirrjes
20. OT - Operatorë të tjerë

### 1.3. STANDARDE DHE REKOMANDIME

Për hartimin e specifikimeve teknike për zbatimin e portabilitetit të numrit janë marrë parasysh standardet dhe rekomandimet e mëposhtme:



1. ETSI TR 101 119 - Network Aspects (NA); High level description of number portability;
2. ETSI TR 102 081 - Network Aspects (NA); Number Portability Task Force (NPTF); Signalling Requirements for Number Portability;
3. ETSI EN 301 716 - Digital cellular telecommunications system (Phase 2+); Support of Mobile Number Portability (MNP); Technical Realisation;
4. ITU-T Q.763 –Signalling System No.7 – ISDN User Part formats and Codes;
5. ITU-T I.130 - Method for the characterization of telecommunication services supported by an ISDN and network capability of an ISDN;
6. ITU-T Q.850 - Usage of cause and location in the Digital Subscriber Signalling System No. 1 and the Signalling System No. 7 User Part;
7. ETSI TS 123 140 – Digital Cellular Telecommunications System (Phase 2+); Universal Mobile Telecommunications System (UMTS); Multimedia Messaging Service(MMS); Functional description; Stage 2 (3 GPP TS 23.140).

## 2. SPECIFIKIME TEKNIKE PËR ZBATIMIN E PORTABILITETIT TË NUMRIT.

### 2.1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Specifikimet teknike përshkruajnë kërkesat e vëna për operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve telefonike të disponueshëm për publikun në këndvështrimin e rrugëzimit të thirrjeve dhe mesazheve në mënyrë që të zbatohet implementimi i bartjes së numrit.

Specifikimet teknike përfshijnë:

- a) detyrimet e operatorëve të rrjeteve dhe shërbimeve telefonike të disponueshëm për publikun për implementimin e portabilitetit të numrit (sipas Nenit 5 dhe Nenit 6 të Rregullores për Portabilitetin);
- b) përshkrim të detajuar të portabilitetit të numrit, sipas kategorive të numrave që barten (numrat gjeografike dhe të lëvizshëm. -Pika 1 e Nenit 3 të Rregullores për Portabilitetin);
- c) rrugëzimin e thirrjeve, drejt numrave të bartur (sipas Nenit 7 të Rregullores për Portabilitetin);
- d) kodet e rrugëzimit (sipas Nenit 25 të Rregullores së Numeracionit), mënyra e transmetimit dhe formati i informacionit të rrugëzimit në ndërfaqen teknike ndërmjet rrjeteve;
- e) të dhënat që duhet të shkëmbehen për të përditësuar informacionin e rrugëzimit.

### 2.2. DETYRIMET E OPERATORËVE TË RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE TELEFONIKE TË DISPONUESHËM PËR PUBLIKUN PËR IMPLEMENTIMIN E PORTABILITETIT TË NUMRIT

Detyrimet e operatorëve të rrjeteve dhe shërbimeve telefonike të disponueshëm për publikun për implementimin e portabilitetit të numrit burojnë nga Ligji 9918, Neni 87 “Portabiliteti i numrave”.

Në mënyrë që të zbatohet Portabiliteti i Numrit, operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve telefonike të disponueshëm për publikun kanë dy lloje detyrimesh:

1. t’i ofrojnë pajtimtarëve, sipas kërkesës, mundësinë e bartjes të numrave gjeografike dhe të lëvizshëm;
2. të rrugëzojnë thirrjet tek numrat e bartur.

Operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve telefonike të disponueshëm për publikun janë të vetmit që kanë detyrimin për t’i ofruar pajtimtarëve të tyre mundësinë e bartjes së numrave nga njëri operator tek tjetri.

Operatorët që kanë detyrimin për të siguruar rrugëzimin e thirrjeve tek numrat e bartur janë të përcaktuar në nenin 7 të Rregullores për Portabilitetin.

### 2.3. PËRSHKRIM I SHËRBIMIT TË PORTABILITETIT TË NUMRIT

Portabiliteti i numrave aplikohet tek numrat e PKN-së të përkufizuara në përputhje me Rekomandimin ITU-T E.164 (Plani ndërkombëtar publik i numeracionit për shërbimet e telekomunikacionit). Numrat e bartshëm i përkasin kategorive të mëposhtme në Rregulloren e Numeracionit:

- a) Numrat gjeografikë, caktuar te operatorëve te rrjeteve dhe shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun;
- b) Numrat e lëvizshëm, caktuar operatorëve te rrjeteve dhe shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun, pa marrë parasysh metodën e pagesës (kontratë ose para-pagim);

Numrat e përdorur ekskluzivisht brenda një rrjeti, dhe çdo kategori tjetër numrash që nuk janë pjesë e PKN-së (P.sh. Numrat IMSI- *International Mobile Subscriber Identity*) nuk janë të bartshëm.

Destinacioni i numrave të bartshëm (lidhur me PKN) nuk mund të ndryshohet.

Bartja e Numrit aplikohet tek:

- a) Numrat individual të caktuar pajtimtarëve;
- b) Numrave të shumëfishtë caktuar pajtimtarëve (p.sh. për shërbimet ISDN-BRA);
- c) Grupe numrash te përdorura brenda rrjeteve private të komunikimeve elektronike (të caktuara për pajisjet PBX ose shërbimet ISDN-PRA).

Bartja e numrit mund të jetë:

- a) bartje individuale: në këtë rast bartet një numër i caktuar
- b) bartje e plotë: në këtë rast barten të gjithë numrat individual, të shumëfishtë ose të grupit.
- c) Bartje e pjesshme: në këtë rast barten vetëm një pjesë e numrave të përzgjedhur nga totali i numrave të shumëfishtë ose të grupit.

---

### 2.3.1. PORTABILITETI I NUMRAVE GJEOGRAFIK (PNG)

Portabiliteti i numrave gjeografik i krijon mundësinë një pajtimtari për të mbajtur numrin e tij gjeografik, në një vendndodhje gjeografike të caktuar, ndërsa kalon tek një operatorët tjetër i rrjeteve dhe shërbimeve telefonike të disponueshëm për publikun.

ODh dhe OM duhet të ofrojnë shërbime brenda së njëjtës zone gjeografike dhe duhet të zotërojnë nëpërmjet një Autorizimi Individual seri numrash gjeografike brenda së njëjtës zonë, pavarësisht faktit nëse janë në një seri numrash apo në seri të ndryshme numrash.

Numrat e bartshëm gjeografike përmbahen në seritë numerike 2, 3, 4, 5 dhe 8 sikurse përshkruhet në, pikën 1/a të Nenit 6 të Rregullores së Numeracionit.

Të gjitha seritë numerike gjeografike që përmbajnë numra të bartshëm publikohen në web-in e AKEP-it dhe në web-in e OfDBRC-së.

Operatoret mund tu caktojnë pajtimtarëve të tyre një ose disa numra. Në rastin e caktimit të disa numrave gjeografike, mund të paraqiten këto raste:

- a) Caktimi i disa numrave për një pajtimtar ne linja të veçanta(analoge ose teknologji të tjera) për shërbimin telefonik, shërbimin data, shërbimin fax(numra që janë te pavarur nga njeri tjetri);
- b) Caktimi i numrave të shumëfishtë(MSN) për një pajtimtar. Shërbimi realizohet nëpërmjet aksesit ISDN-BRA. Në këtë rast mund të kemi deri në 10 numra nga të cilët njeri është kryesori (brenda rrjetit transmetohet vetëm CLI e tij);

- c) Grup numrash caktuar për një PABX, përdorur për DDI(Direct Dialing) PABX. Shërbimi realizohet nëpërmjet aksesit ISDN-PRA. Një nga numrat e grupit është kryesori (brenda rrjetit transmetohet vetëm CLI e tij);
- d) grup numrash caktuar për një PBX, pavarësisht tipit të aksesit. Ky grup është i lidhur me një numër bazë (CLI e të cilit transmetohet brenda rrjetit). Zakonisht, numri baze merret për akses te PBX, ndërsa aksesi për linjat e shtuara mund të realizohet ose nga një operator, ose duke përdorur mënyra e thirrjes me dy hapa.

*Rregullat e bartjes:*

Në rastin kur pajtimtarit i janë dhënë numra të ndryshëm (pika a)), numra të shumëfishtë (MSN) (pika b)), ai mund të kërkojë një bartje individuale, të pjeshme ose të plotë për numrat respektive. Në rastin e bartjes të pjeshme ose individuale të numrave MSN, nuk duhet të aplikohet asnjë kufizim në lidhje me numrin kryesor.

Në rastet e grupeve të numrave të dhënë për PBX/PABX (pikat c) e d)), mund të kërkohe bartje e pjeshme ose e plotë si me poshtë :

1. Një grup minimal i bartshëm përfshin deri në 10 numra;
2. Për PBX/PABX që kanë grupe të ndara të përbëra nga dhjetëshe numrash lejohet bartja e X grupeve për çdo 10 numra PBX/PABX, përveç bartjes së plotë e cila është e lejuar;
3. Për PBX/PABX që kanë grupe të ndara të përbëra nga qindëshe numrash lejohet bartja e grupeve Y të 100 numrave, përveç bartjes të plotë e cila është e lejuar;
4. Për PBX/PABX që kanë grupe të ndara prej 1000 numrash lejohet bartja e grupeve Z prej 1000 numrash, përveç bartjes së plotë që është e lejuar.

Grupet e numrave të bartshëm janë sekuencat e numrave, i pari i të cilëve mbaron me 0, 00 ose 000 bazuar në sekuencën e bartur, sipas germave b÷d) si me sipër.

---

### 2.3.2. PORTABILITETI I NUMRAVE TË LËVIZSHËM (PNL)

Portabiliteti i numrave për shërbimet telefonike të lëvizshme i referohet mundësisë që ka pajtimtari për të mbajtur një numër E.164(MSISDN), kur kalon tek një operator tjetër i rrjeteve dhe shërbimeve telefonike të disponueshëm për publikun. Të gjithë numrat e përdorur për ofrimin e shërbimeve të lëvizshme telefonike janë numra të bartshëm, pavarësisht teknologjisë së përdorur (2G, 3G, CDMA etj.). Numrat e përdorur për shërbimin me parapagim, fax dhe data janë gjithashtu të bartshëm.

Numrat me shërbimin me parapagim janë të bartshëm sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 5 të Rregullores për Portabilitetit.

Numrat e bartshëm të lëvizshëm përmbahen në serinë numerike 6 sikurse përshkruhet në pikën 1/b të Nenit 6 të Rregullores të Numeracionit.

Operatorët mund të caktojnë pajtimtarëve të tyre një ose disa numra. Në rastin e caktimit të disa numrave të lëvizshëm, mund të paraqiten këto raste:

- a) caktimi i disa numrave për një pajtimtar, në karta SIM të veçanta ose pajisje të tjera;

- b) caktimi i numrave të shumëfishtë për një pajtimtar për shërbime zanore, shërbime data, shërbime fax-i në një kartë SIM (këto janë numra të pavarur nga njëri-tjetri, por të lidhur me një kartë SIM);
- c) caktimi i disa numrave për GSM Gateway për një pajtimtar, numra të cilët mund të marrin ose nuk mund të marrin thirrje;
- d) grupe numrash caktuar për një PABX;

*Rregullat e bartjes:*

Në rastin e caktimit të disa numrave një pajtimtari, në karta të veçanta SIM ose pajisje të tjera, pajtimtari mund të kërkojë një bartje individuale, të pjesshme ose të plotë për numrat respektive.

Në rastin e caktimit të numrave të shumëfishtë një pajtimtari për shërbime zanore, shërbime data, shërbime fax-i në një kartë SIM, pajtimtari mund të kërkojë një bartje individuale, të pjesshme ose të plotë për numrat respektive. Në rastin e bartjes të pjesshme ose individuale të numrave MSN, nuk duhet të aplikohet asnjë kufizim.

Në rastet e grupeve të numrave të dhënë për PABX (pika d)), mund të kërkojë bartje të pjesshme ose të plotë si më poshtë :

1. Një grup minimal i bartshëm përfshin deri në 10 numra;
2. Për PBX/PABX që kanë grupe të ndara të përbëra nga dhjetëshe numrash lejohet bartja e X grupeve për çdo 10 numra PBX/PABX, përveç bartjes së plotë e cila është e lejuar;
3. Për PBX/PABX që kanë grupe të ndara të përbëra nga qindëshe numrash lejohet bartja e grupeve Y të 100 numrave, përveç bartjes të plotë e cila është e lejuar;
4. Për PBX/PABX që kanë grupe të ndara prej 1000 numrash lejohet bartja e grupeve Z prej 1000 numrash, përveç bartjes së plotë që është e lejuar.

Grupet e numrave të bartshëm janë sekuencat e numrave, i pari i të cilëve mbaron me 0, 00 ose 000 bazuar në sekuencën e bartur, sipas germave b÷d) si më sipër.

Numrat e dhënë për GSM Gateway që nuk mund të marrin thirrje nuk duhet të barten.

## 2.4. RRUGËZIMI I THIRRJEVE

### 2.4.1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Ofrimi i shërbimit të bartjes së numrit kërkon një seri ndryshimesh në rrjete, kryesisht për të siguruar rrugëzimin korrekt të thirrjeve drejt numrave të bartur.

Një thirrje do të rrugëzohet tek numri i thirrur bazuar në analizën e shifrave në direktorinë respektive të numrave (DN). DN transmetohet nëpërmjet parametrit CdPN në IAM(Initial Address Message) në Sistemin e sinjalizimit SS7 (Rekomandimi ITU-T Q.763).

Para zbatimit të portabilitetit të numrit, shifrat e para në strukturën DN (prefiksi kombëtar-CC, kodi i destinacionit kombëtar-NDC dhe sekuenca e shifrave që identifikon grupin e numrave të caktuar nga AKEP-i një operatori të caktuar, bazuar në një Autorizim Individual) përdoren për të dhënë informacion për rrugëzimin e thirrjes në rrjetin destinacion. Numri i shifrave të analizuar është i ndryshëm në kategori të ndryshme numrash.

Në rastet e numrave gjeografik, (Neni 6/1a në Rregulloren e Numeracionit) sekuenca e 3-5 shifrave të para zakonisht identifikon një central lokal në rrjetin PSTN/ISDN ose numrat e caktuar një operatori në një zonë gjeografike të dhënë.

Në rastin e numrave jo gjeografik për shërbimet e telefonisë së lëvizshme, (Neni 6/1b në Rregulloren e Numeracionit) sekuenca e 2-3 shifrave të para identifikon një operator të telefonisë së lëvizshme.

Numrat e tjerë në sekuenca zakonisht përdoren në rrjetin destinacion nga centrali lokal, në procesin e kalimit nga E.164 në IP (për rrjete IP) ose nga direktoritë e pajtimtarëve (HLR, VLR).

Pas zbatimit të portabilitetit të numrit, analiza e sekuençës së shifrave në numrin e thirrur, të përbërë nga prefiksi kombëtar(CC), kodi i destinacionit kombëtar(NDC) dhe nga grupi i shifrave(SN) që identifikojnë serinë numerike, caktuar për përdorim një operatori me anë të Autorizimit Individual, nuk mjafton më për identifikimin e rrjetit në të cilin numri është bartur. Kështu që në këtë rast mesazhet sinjalizuese duhet të përfshijnë një informacion shtesë të rrugëzimit.

Në këtë rast, rrjetet që marrin pjesë në rrugëzimin e thirrjes duhet të përmbushin funksionet e mëposhtme specifike të portabilitetit:

1. Vendosjen e një mekanizmi për të identifikuar në se numri është i bartur apo jo
2. Nxjerrjen nga DBROp e informacionit të rrugëzimit;
3. Futjen e informacionit të rrugëzimit në mesazhin sinjalizues;
4. Rrugëzimin e thirrjes ndërmjet dhe brenda rrjeteve, bazuar njëkohësisht në DN dhe në informacionin rrugëzues.

Përcaktimi i operatorit që do të kryejë nxjerrjen e informacionit për rrugëzimin e thirrjeve është shumë i rëndësishëm sepse përfshin detyrimin e këtij operatori për të përballuar kostot shtesë për rrugëzimin e thirrjes tek numrat e bartur. Operatorët e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshëm për publikun sipas përcaktimit në nenin 7 të Rregullores për Portabilitetin kanë detyrimin të sigurojnë rrugëzimin e sakte të thirrjeve. Detyrimi për rrugëzimin e një thirrjeje mund të përmbushet nga vetë operatori ose nëpërmjet të marrëveshjeve kontraktore me operatorin tranzitues që përdor ACQ,

---

#### 2.4.2. METODA E RRUGËZIMIT

Në Rregulloren për Portabilitetin është përcaktuar se metoda e rrugëzimit të thirrjeve që do të përdoret për zbatimin e portabilitetit të numrit është ACQ.

ACQ është metoda me e përdorur në këndvështrimin e zbatimit të portabilitetit të numrit.

Të gjithë operatorët që marrin pjesë në procesin e bartjes të numrit duhet të mbështesin rrugëzimin e thirrjeve në numrat e bartur gjeografik dhe të lëvizshëm sipas përcaktimeve të nenit 7 të Rregullores për Portabilitetin.

### 2.5. KODET E RRUGËZIMIT

---

#### 2.5.1. TË PËRGJITHSHME

Në mënyrë që të rrugëzohen thirrjet tek numrat e bartur, direktoria e numrit të thirrur (DN) ka nevojë për informacion shtesë rrugëzimi, respektivisht kodin e rrugëzimit (NR). Në vijim të kërkesës drejtuar DBROp për të kontrolluar nëse numri është i bartur, nxirret kodi i rrugëzimit. Informacioni i plotë i rrugëzimit përmban kodin e rrugëzimit(NR) dhe direktorinë e numrin (DN).

Informacioni i rrugëzimit do të transmetohet në piken e interkoneksionit të rrjeteve me metodën e “vargëzimit të adresave”(concatenated addresses). RN dhe DN do të transmetohen së bashku në parametrin CdPN në mesazhin IAM të sistemit të sinjalizimit ISUP.

Për te dalluar DN nga vargu RN vargëzuar me ND, të cilët te dy transmetohen brenda një parametri sinjalizues numri i pare (grupi i numrave) ne numrin e rrugëzimit (prefiksi i kodit te rrugëzimit) nuk duhet të përdoret në PKN;

*Shënim: -numeracioni ne PKN me numrin/numrat e pare identike me ato të numrit te rrugëzimit nuk është i disponueshëm për t'u caktuar për përdorim nga AKEP.*

Numrat e rrugëzimit mund te identifikojnë rrjetin destinues, një pike interkoneksioni ose një central ne rrjetin destinues.

Thirrjet drejt numrave të bartur duhet te kalojnë ne një rrugëzim me dy hapa për numrat gjeografike, në rastet e rrjeteve bazuar ne teknologjinë IP, ku thirrjet rrugëzohen ne rrjetin destinues me ane te përkthimit të numrave ne adresa IP. Ne këto raste, numri i rrugëzimit është i mjaftueshëm për identifikimin e rrjetit destinues ( rrjeti marres).

## 2.5.2. STRUKTURA E KODEVE TË RRUGËZIMIT

Kodet e rrugëzimit, sikurse përcaktohet në Nenin 25 të Rregullores së Numeracionit, kanë 4 shifra të grupuara sipas formatit 99xx, në të cilin:

- a) grupi i 99-te është prefiksi i kodit të rrugëzimit;
- b) grupi xx është kodi i operatorit (ID) që merr pjesë në procesin e bartjes.

Grupi xx i caktohet çdo operatori, ne varësi te rolit të numrit te rrugëzimit ne rrjetin e operatorit:

-operatoret e shërbimeve telefonike te disponueshme për publikun te ofruara nëpërmjet rrjeteve te lëvizshme publike duhet te përdorin një numër rrugëzimi qe tregon rrjetin tek i cili numri i bartur është lidhur;

-operatoret e shërbimeve telefonike te ofruara nëpërmjet rrjeteve fikse publike mund te përdorin një ose disa numra rrugëzimi, sipas teknologjisë se përdorur brenda rrjeteve të tyre (PSTN/ISDN ose IP); një numër rrugëzimi do te tregojë ose rrjetin me të cilin është lidhur numri i bartur ose një central ne një rrjet tjetër.

Kombinimi 99xx=9900, nuk do te caktohet, por do te përdoret gjate proceseve administrative, kur numri i bartur kthehet ne numër jo të bartur( në rastin kur operatori marres është operatori dhënës fillestar).

Kodet e rrugëzimit do të menaxhohen nga AKEP-i, bazuar në një procedurë transparente. Duke marre parasysht se dy numrat e pare të numrit te rrugëzimit do te jene gjithmonë 99, do te jene te mundura jo me shume se 99 kombinime. Në qoftë se numrat e rrugëzimit do të jenë të pamjaftueshëm, AKEP-i ka të drejtën të ndryshojë formatin e kodeve të rrugëzimit dhe të vërë rregulla për dhënien dhe përdorimin e tyre.

## 2.6. SHKËMBIM INFORMACIONI NË NDËRFAQEN ADMINISTRATIVE

Rrugëzimi i thirrjeve drejt numrave të bartur bëhet ndërmjet DBROp-ve.

Operatoret e DBROp-ve pyeten në kohë reale në momentin e origjinimit të thirrjes, për të marre informacionin e rrugëzimit.

Operatorët duhet të jene shume te kujdesshëm ne përditësimin e informacionit te rrugëzimit në DBROp-te e tyre. Për këtë qëllim, ata përdorin informacionin në DBRC.

DBRC dërgon këtë informacion nëpërmjet ndërfaqes administrative, në përputhje me rregullat e kapitullit 3 të këtij dokumenti. Një informacion i tillë interpretohet dhe përdoret nga çdo operator gjatë përditësimit të informacionit të rrugëzimit në DBROp-ne e tij.

Informacioni i duhur që do të transmetohet nga DBRC përfshin:

- a) (DN); Numrin e bartur
- b) (NR); Kodin e rrugëzimit
- c) Koha e bartjes (viti, muaji, data, ora);
- d) ID ODh;
- e) ID ODhF;
- f) ID OM.

DBRC do të ketë mundësi që në mënyrë opsionale të transmetojë detaje të tjera.

### 3. PËRSHKRIM I DETAJUAR I PROCEDURËS PËR MENAXHIMIN E PROCESIT TË BARTJES

#### 3.1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

DBRC duhet të realizojë menaxhimin e procesit të bartjes, përfshirë shkëmbimin e informacionit të operatorëve mbi numrat e bartur.

DBRC mban informacion mbi numrat e bartur dhe kodet e rrugëzimit.

Procesi i administrimit lidhur me zbatimin e portabilitetit të numrit, përfshin disa nënprocese ose faza. Çdo proces është përmendur bashkë me faktorët që përfshihen, shkëmbimin e informacionit, veprimet e kryera dhe afatet e tyre. Shkëmbimi i informacionit realizohet nëpërmjet mesazheve sipas përshkrimit në pikën 4 të nenit 8 të rregullores për portabilitetin (RNP N8.4), të cilat janë specifike për çdo proces.

OfDBRC duhet të përgatisë dokumente të detajuara të implementimit teknik. Këto dokumente përfshijnë specifikime për ndërfaqet e komunikimit ndërmjet operatorëve dhe DBRC-së, parametrat e mesazheve, afatet kohore dhe kodet e gabimit që gjenerohen nga sistemi.

#### 3.2. PROCESET ADMINISTRIMIT TË LIDHURA ME ZBATIMIN E PORTABILITETIT TË NUMRIT.

Në zbatimin e portabilitetit të numrit, DBRC duhet të suportojë proceset e mëposhtme:

1. bartja
2. shkëputja
3. ndryshimi i informacionit të rrugëzimit
4. sinkronizimi
5. transferimi i një blloku numrash
6. informimi mbi statusin e sistemit

#### 3.3. PROCESI I BARTJES

Procesi i bartjes është procesi ndërmjet momentit kur dorëzohet një kërkesë për bartje dhe momentit kur thirrja mund të përfundojë në mënyrë të saktë tek numri i bartur.

Procesi i bartjes kalon në dy faza, vlerësimi i kërkesës për bartje nga OM dhe bartja vetë.

Gjithashtu gjatë këtij procesi identifikohen dy nënprocese të tjera:

1. Anullimi i kërkesës për bartje
2. Ndërprerja e procesit

Një pajtimtar mund të kërkojë bartjen e një numri, të disa numrave apo të një grupi numrash. Në qoftë se një pajtimtar kërkon bartjen e njëkohshme të disa numrave, këto duhet të jenë pjesë e të njëjtës kategori numerike. Në të gjitha rastet, kjo kërkesë duhet të trajtohet si një kërkesë bartje e cila përfshin të gjitha numrat.

### 3.3.1. VLERËSIMI I KËRKESËS PËR BARTJE

Kjo fazë fillon pas përfundimit të procedurave para kërkesës për bartje të përshkruara në nenin 13 të rregullores për portabilitetin, bazuar në pikën 1 të nenit 14 të rregullores së sipërcituar kur OM dërgon kërkesën për bartje. Koha kur mesazhi merret nga DBRC në këtë dokument do të shënohet  $t_0$  dhe konsiderohet si momenti kur fillon procesi bartjes në lidhje me afatet kohore të trajtuara në rregulloren e portabilitetit në nenet 12, 14, 15 dhe 16.

Faza e vlerësimit të kërkesës për bartje ka si qëllim të arrihet pranimi nga palët e përfshira në procesin e bartjes (OM, ODh) për procesin dhe afatet e tij. Gjatë kësaj faze përcaktohet  $t_{\text{bartjes}}$  që është momenti (koha) kur do të aktivizohet bartja. Deri në momentin  $t_{\text{bartjes}}$  merr shërbim nga ODh sipas kontratës që ka me të. Pas këtij momenti pajtimtari duhet të marrë shërbimin nga OM sipas kontratës së re të lidhur në kohën e plotësimit të kërkesës për bartje. Kontrata e vjetër me ODh konsiderohet e anuluar pas momentit  $t_{\text{bartjes}}$  sipas pikës 3 të nenit 4 të rregullores për portabilitetin (RNP N4.3).

Kjo fazë fillon në momentin kur OM dërgon kërkesën për bartje tek DBRC dhe mbaron në momentin kur ODh pranon ose nuk pranon kërkesën.

Mesazhet e dërguara gjatë fazës së vlerësimit të kërkesës janë si më poshtë:

**KBO** - kërkesa për bartje e operatorit: kërkesa për bartjen e numrit dërgohet nga OM tek DBRC;

**KBO<sub>DBRC</sub>** - kërkesa për bartje e operatorit me informacionet shtese (ku përfshihet numri i referencës dhe kohen e mundshme për bartjen) të përcaktuara nga DBRC: kjo kërkesë dërgohet nga DBRC tek ODh;

**PKB** - përgjigje për kërkesën për bartje: përgjigja e ODh-së për KBO, me anë të së cilës ODh pranon (PKB<sub>A</sub>) ose nuk pranon (PKB<sub>R</sub>) të bartë numrin respektiv. Mesazhi i marrë mund të japë pranim të plotë ose të pjesshëm të kërkesës për bartje;

**A<sub>KBO</sub>** - pranimi i kërkesës për bartje nga DBRC : mesazhi konfirmues dërgohet nga DBRC tek OM, nga i cili pranohet KBO;

**R<sub>KBO</sub>** - mospranimi i kërkesës për bartje nga DBRC: mesazhi i përgjigjes i dërguar nga DBRC me të cilin nuk pranon KBO; Mesazhet A<sub>KBO</sub> dhe R<sub>KBO</sub> janë pjesë e mesazheve të DBRC-së.

Diagrama 1 tregon mesazhet e shkëmbyera gjatë fazës së vlerësimit të kërkesës së bartjes.






Diagrama 1

Momenti kur OM i dërgon kërkesën për bartje DBRC-së konsiderohet si fillimi për procesin e bartjes ( $t_0$ ).  
Momenti kur OM merr mesazhin PKBA ose PKBR nga DBRC përcakton fundin e fazës së vlerësimit.

Gjatë kësaj faze kryhen veprimet e mëposhtme:

**P<sub>1a1</sub>:**

OM dërgon kërkesën për bartje KBO tek DBRC. KBO duhet të përmbajë të gjithë informacionet e përshkruara në pikën 2 të nenit 17 të rregullores për portabilitetin.

**P<sub>1a2</sub>:**

1. kërkesa për bartje e marrë nga DBRC regjistrohet në tabelën e DBA (RNP N8.4). Tabela e DBA-se që mban mesazhet implementohet në bazë të parimit të radhës (FIFO).  
DBRC kontrollon mesazhin, dërgon përgjigjen e marrjes së mesazhit tek OM si më poshtë:
  - në qoftë se mesazhi KBO nuk pranohet, DBRC dërgon mesazhin e mos pranimit ( $R_{KBO}$ ) tek OM. Mesazhi i mospranimit përfshin kodin e gabimit dhe në mënyrë opsionale përshkrimin e gabimit. (RPN N14.3)
  - në qoftë se kërkesa për bartje pranohet, DBRC cakton një numër referencë për kërkesën, dërgon tek OM mesazhin  $A_{KBO}$  i cili përmban numrin e referencës, dhe konfirmon pranimin e KBO, ndërkohë përmbajtja e mesazhit KBO së bashku me numrin e referencës, dhe intervalin kohor të caktuar për bartjen sipas pikës 2 të nenit 16, dërgohet menjëherë si mesazh  $KBO_{DBRC}$  tek ODh, bazuar në parimin FIFO (first in first out).

Kërkesat e dërguara në një ditë konsiderohen ato të dërguara deri në orën 16:00.

2. DBRC përditëson listën respektive të kërkesave për bartje (në DBA).

**P<sub>1a3</sub>:**

1. ODh kontrollon mesazhin  $KBO_{DBRC}$  e marrë nga DBRC.
2. ODh dërgon mesazhin PKBA/PKBR tek DBRC, i cili tregon pranimin ose mospranimin e kërkesës për bartje.

**P<sub>1a4m</sub> (mospranimi):**

Në rastin e mospranimit ODh dërgon mesazhin PKBR tek DBRC, i cili tregon mospranimin e kërkesës për bartje dhe do të përfshijë arsyet e këtij mospranimi (kodi i problemit dhe, në mënyrë opsionale, përshkrimi i problemit). Ky mesazh dërgohet edhe në rastin e pranimit të pjesshëm (pra kur për disa nga numrat që përmban kërkesa nuk pranohet bartja). Në këtë rast mesazhi duhet të përfshijë secilin nga numrat për të cilët nuk pranohet bartja me arsyet përkatëse të mospranimit.

Rastet e mospranimit janë vetëm ato të parashikuara në Rregulloren për Portabilitetin.

1. DBRC dërgon mesazhin PKBR<sub>DBRC</sub> tek OM i cili përmban arsyet e këtij mospranimi (kodi i problemit dhe, në mënyrë opsionale, përshkrimi i problemit).
2. DBRC përditëson listën respektive të kërkesave për bartje (ne DBA).

**P<sub>1a4p</sub> (pranimi):**

Në rastin e pranimit ODh saktëson kohën e bartjes bazuar në kohën e propozuar nga KBO<sub>DBRC</sub> dhe e dërgon tek DBRC me mesazhin PKBA, i cili tregon pranimin e kërkesës për bartje.

1. DBRC pas marrjes së mesazhit PKBA kontrollon nëse koha e bartjes e caktuar nga ODh, është brenda intervalit të caktuar (sipas KBO<sub>DBRC</sub> respektive). Në qoftë se po atëherë konfirmon kohën e sakte të bartjes ( $t_{bartjes}$ ), përndryshe cakton si  $t_{bartjes}$  fillimin e intervalit të KBO<sub>DBRC</sub> respektive.
2. DBRC dërgon mesazhin PKBA<sub>DBRC</sub> tek OM dhe ODh në të cilin specifikohet koha e saktë ( $t_{bartjes}$ ) kur mund të bëhet bartja.
3. DBRC përditëson DBR.
4. DBRC përditëson listën respektive të kërkesave për bartje (ne DBA).

**P<sub>1a5</sub>:**

1. Pasi të ketë marrë mesazhin PKBA<sub>DBRC</sub>, OM dhe ODh përgatitin fazën e bartjes




Diagrama e aktiviteteve për procesin e vlerësimit të kërkesës për bartje.

3.3.2. FAZA E AKTIVIZIMIT TË BARTJES

Para fazës së aktivizimit deri ne momentin  $t_{\text{bartjes}}$ , OM dhe ODh duhet të bëjnë të gjithë veprimet teknike për përgatitjen e bartjes në mënyrë që të mund të realizohet bartja në kohën e vendosur nga DBRC. Të gjithë operatorët deri në këtë moment duhet të kenë përditësuar DBROp e tyre (NRP N16.2). ODh përgatit shkëputjen e shërbimit për numrin që do të bartet dhe ne kohen e bartjes ( $t_{\text{bartjes}}$ ) e kryen atë, dhe menjëherë dërgon mesazhin SKDh tek DBRC.

Mesazhet e dërguara gjatë kësaj faze të bartjes janë si më poshtë:

**SKDh** – shkëputja e kryer nga dhënësi: mesazhi i dërguar nga ODh, që konfirmon se shkëputja është kryer nga ODh;

**ASKDh/RSKDh** – pranim/mospranim nga DBRC i mesazhit të shkëputjes dërguar nga ODh

**NRAk** – numri i aktivizuar: shërbimi për numrin është aktivizuar OM dhe është funksional

Diagrama 2 ilustron shkëmbimin e mesazheve gjatë kësaj faze.




Diagrama 2

ODh ka përgatitur shkëputjen e shërbimit për numrin që do të bartet. Gjatë kësaj faze kryhen veprimet e mëposhtme:

**P<sub>2a1</sub>:**

1. ODh i dërgon DBRC-së mesazhin SKDh duke informuar se procesi shkëputjes është kryer. (numri i bartur është çaktivizuar nga ODh dhe është futur në DBROp e tij si numër i bartur)

**P<sub>2a2</sub>:**

1. DBRC dërgon mesazhin pranues/mospranues ( $A_{SKDh}/R_{SKDh}$ ) tek ODh.
  - 2a. në qoftë se mesazhi pranohet, DBRC dërgon mesazhin  $A_{SKDh}$  tek ODh, dhe njëkohësisht i dërgon OM mesazhin SKDh të marrë nga ODh,
  - 2b. në qoftë se mesazhi nuk pranohet, DBRC dërgon mesazhin  $R_{SKDh}$  tek ODh duke treguar kodin e problemit dhe përshkrimin e tij.

**P<sub>2a3</sub>:**

1. Pasi të ketë marrë mesazhin SKDh, OM kryen veprimet për aktivizimin e shërbimit për numrin e kërkuar.
2. OM kontrollon nëse procesi i bartjes ka përfunduar dhe shërbimi i dhënë për numrin e bartur është funksional. Shërbimi konsiderohet funksional kur nga numri i bartur është aktiv (originon dhe merr thirrje)

3. OM dërgon mesazhin NRAK tek DBRC. Ky mesazh konfirmon se procesi i bartjes për numrin ka përfunduar me sukses.

**P<sub>2a4</sub>:**

1. DBRC dërgon mesazhin SKDh tek OM
2. DBRC përditëson listën respektive të kërkesave për bartje (ne DBA)

**P<sub>2a5</sub>:**

1. OM dërgon mesazhin e konfirmimit PIR tek DBRC kur shërbimi është funksional dhe njëkohësisht përditëson DBROp te tij me informacionin e rrugëzimit për numrin e bartur.

**P<sub>2a6</sub>:**

1. Në qoftë se DBRC merr mesazhin PIR nga OM, do të thotë se shërbimi i portabilitetit të numrit mund të regjistrohet si funksional për ODh dhe OM.
2. DBRC përditëson DBR
3. DBRC dërgon mesazhin PIR<sub>A</sub> tek të gjithë operatorët, përveç OM. Për operatorët, ky mesazh do të thotë se informacioni i rrugëzimit duhet përditësuar.
4. DBRC përditëson listën respektive të kërkesave për bartje (ne DBA)

**P<sub>2a7</sub>:**

Të gjithë operatorët që origjinojnë thirrje përditësojnë informacionin e rrugëzimit në DBROp e tyre që përmbajnë numrat e bartur, bazuar në informacionin në DBRC të dërguara nga mesazhi PIR dhe dërgojnë mesazhin IRP si një përgjigje të mesazhit PIR.

Koha maksimale për operatorët që përditësojnë DBROp e tyre me DBRC duhet të jetë në përputhje me kohën e vendosur në pikën 4 të nenit 7 të Rregullores për Portabilitetin. Operatorët do të vendosin në qoftë se do të përditësojnë DBROp në kohë reale ose në intervale të caktuara kohe.

---

### 3.3.3. NËNPROCESI I ANULLIMIT TE KËRKESAVE PËR BARTJE

#### I. KËRKESË PËR ANULLIM NGA OM

OM mund të kërkojë një anulim të kërkesës për bartje duke dërguar një kërkesë anulimi tek DBRC. Një kërkesë bartje mund të anulohet kur DBRC të ketë pranuar mesazhin KBO (duke dërguar mesazhin A<sub>KBO</sub>), jo më vonë se  $t_{\text{bartjes}}$ .

Anullimi i kërkesës për bartje mund të ndodhë në një nga rastet e mëposhtme:


- a) bartja nuk është e mundur për arsye teknike të papritura;

një proces i gabuar bartje (pajtimtari nuk ka kërkuar bartje).

Mesazhet e dërguara brenda procesit të anulimit të kërkesës për bartje janë si më poshtë:

**KMA**- kërkesa e marrësit për anulim: mesazhi i dërguar nga OM tek DBRC, që i kërkon ODh të anultojë një kërkesë bartja të dërguar më parë;  
**A<sub>KMA</sub>/R<sub>KMA</sub>** – Pranimi ose mospranimi nga DBRC i kërkesës së anulimit

Diagrama 3 ilustron shkëmbimin e mesazheve brenda nënprocesit për anulimin e kërkesës së bartjes të OM.



**Diagrama 3**

Veprimet në këtë faze janë:

**P<sub>3a1</sub>:**

OM dërgon mesazhin KMA tek DBRC, duke kërkuar anulimin e kërkesës për bartje.

**P<sub>3a2</sub>:**

1. DBRC dërgon mesazhin konfirmues AKMA, në qoftë se kërkesa për anulim është e vlefshme ose mesazhi mospranues R<sub>KMA</sub> që përmban kodin e gabimit.
2. Në rast pranimi të KMA, DBRC duhet të dërgojë kërkesën për anulim tek ODh.

**P<sub>3a3</sub>:**

1. ODh përpunon kërkesën për anulim dhe ndalon veprimet e lidhura me bartjen e numrit përkatës.
2. ODh dërgon konfirmimin e kërkesës për anulim AKMA.

### 3.4. PROCESI I RIKTHIMIT TE NJË NUMRI TË BARTUR TEK ODHF.

Rikthimi është procesi me të cilin një numër i bartur rikthehet tek ODhF, me mbarimin e kontratës ndërmjet një pajtimtari dhe OM-se për dhënien e shërbimeve nëpërmjet një numri respektiv.

Brenda 5 ditëve nga shkëputja e numrit respektiv (përfundimi i kontratës ndërmjet pajtimtarit dhe OM-se), OM-ja ka detyrimin të lajmërojë ODhF-në nëpërmjet DBRC-së numri respektiv është shkëputur (nuk është më në përdorim).

Procesi i rikthimit të një numri të bartur fillon nga OM, i cili duhet ti dërgojë DBRC një lajmërim për shkëputjen e numrit të bartur, dhe mbaron kur të gjithë operatorët konfirmojnë fshirjen e informacionit bazë për numrin e bartur të shkëputur.

Brenda këtij procesi, transmetohen mesazhet e mëposhtme:

**LShN**- lajmërim për shkëputje të një numri: mesazhi i dërguar nga OM, duke informuar DBRC-në për shkëputjen e numrit të bartur, i cili do të kthehet tek ODhF-ja;

**PLSh**- pranimi i një lajmërimi për shkëputje: Mesazhi i pranimit të ODhF-së, si një përgjigje e një lajmërimi dërguar nga OM, lidhur me shkëputjen e një numri;

**MLSh** – mospranimi i një lajmërimi për shkëputje: mos pranimit të ODhF-së, si një përgjigje e një lajmërimi dërguar nga OM-ja, lidhur me shkëputjen e një numri.

**FIR**- fshirja e informacionit të rrugëzimit: mesazhi i dërguar DBRC tek të gjithë operatorët duke kërkuar fshirjen e informacionit të rrugëzimit për këtë numër të bartur;

**IFB** – informacioni bazë i fshirë: Përgjigja e operatorit tek DBRC duke konfirmuar fshirjen e informacionit bazë lidhur me numrin e lëvizur.

**ALShN/RLShN** - Pranimit ose jo i DBRC-së i lajmërimit të shkëputjes.

Diagrama 5 ilustron shkëmbimin e mesazheve gjatë procesit të shkëputjes.




Diagrama 5

Veprimet e lidhura me proceset e shkëputjes të një numri janë si më poshtë:

**P<sub>6a1</sub>:**

OM dërgon mesazhin LShN duke informuar DBRC-në për shkëputjen e numrit të bartur.

**P<sub>6a2</sub>:**

DBRC pranon ose jo mesazhin. Në qoftë se mesazhi pranohet, DBRC transmeton mesazhin LShN tek ODhF-ja. DBRC krijon të dhënat lidhur me shkëputjen e numrit të bartur.

**P<sub>6a3</sub>:**

1. ODhF-ja kontrollon nëse numri i shkëputur është pjesë e numrave për të cilët ai është i autorizuar nga një AI.
2. ODhF-ja duhet të dërgojë mesazhin lidhur me pranimin/refuzimin e lajmërimit.

**P<sub>6a4</sub>:**

DBRC përditëson informacionin lidhur me numrin e shkëputur dhe ritransmeton mesazhin e marrë nga ODhF tek OM-ja.

**P<sub>6a5</sub>:**

1. DBRC vendos kodin e rrugëzimit me vlerën e paracaktuar NR=9900 ne informacionin e rrugëzimit të numrit respektiv
2. DBRC dërgon mesazhin FIR, duke informuar ODhF-në dhe operatore të tjerë, përveç OM, mbi përfundimin e statusit të bartjes për këtë numër. ODhF mund ta ripërdorë këtë numër.

**P<sub>6a7</sub>:**

1. Mbas marrjes së mesazhit FIR nga DBRC, operatori duhet të fshijë informacionin e rrugëzimit për numrin e bartur nga DBROp.
2. Operatorët duhet të dërgojnë mesazhin IBF tek DBRC në mënyrë që të konfirmojnë fshirjen e informacionit të rrugëzimit.

**P<sub>6a8</sub>:**

DBRC-ja regjistron të gjitha përgjigjet dhe sigurohet se të gjithë operatorët kanë bërë përditësim të informacionit të rrugëzimit mbas skadimit te intervalit T<sub>3</sub>. DBRC e konsideron të përditësuar informacionin sikur të jetë marrë të paktën një mesazh IBF brenda intervalit.

### 3.5. PROCESI I NDRYSHIMIT TË INFORMACIONIT TË RRUGËZIMIT

Ky proces është i nevojshëm në qoftë se OM ndryshon informacionin e rrugëzimit lidhur me numrat e bartur. Informacioni në DBR dhe DBROp-të e të gjithë operatorëve duhet të modifikohet.


OM-ja dërgon tek DBRC një mesazh me informacionin e rrugëzimit të përditësuar. DBRC ndryshon informacionin në DBR lidhur numrat respektive të bartur dhe kalon mesazhin tek të gjithë operatorët. Pasi kanë bërë ndryshimet, ato konfirmojnë DBRC-në se informacioni i rrugëzimit është përditësuar.

Mesazhet e dërguar gjatë këtij procesi janë si më poshtë:



**NIR** - ndrysho informacionin e rrugëzimit: mesazh i dërguar nga OM tek DBRC;  
**IRN** – informacioni i rrugëzimit i ndryshuar: mesazhi i përgjigjes i dërguar nga operatorët tek DBRC-ja;  
**A<sub>NIR</sub>/R<sub>NIR</sub>**-DBRC pranimi/refuzimi i modifikimit të informacionit të rrugëzimit.

Diagrama 6 ilustron shkëmbimin e mesazheve gjatë procesit të ndryshimit të informacionit rrugëzimit.



**Diagrama 6**

Veprimet e lidhura me procesin e modifikimit të informacionit të rrugëzimit janë si më poshtë:

**P<sub>7a1</sub>:**

OM dërgon tek DBRC mesazhin NIR duke përfshirë informacionin e rrugëzimit të modifikuar.

**P<sub>7a2</sub>:**

1. DBRC dërgon OM-s mesazhin e pranimit ose refuzimit të mesazhit NIR.
2. Në qoftë se mesazhi NIR pranohet, DBRC dërgon mesazhin NIR që përmban informacionin e modifikuar tek të gjithë operatorët që kryejnë thirrje tek numrat e bartur.
3. Në qoftë se mesazhi NIR pranohet, DBRC përditëson informacionin në DBR

**P<sub>7a3</sub>:**

Operatorët modifikojnë DBROp-të e tyre.  
 Operatorët dërgojnë DBRC mesazhin IRN duke konfirmuar se informacioni i rrugëzimit përkatës është modifikuar.

**P<sub>7a4</sub>:**

1. DBRC regjistron përgjigjet e operatorëve dërguar brenda intervalit T<sub>3</sub>.
2. DBRC sigurohet se operatorët kanë përditësuar informacionin e rrugëzimit dhe e quan atë të kryer kur ka marrë të paktën një mesazh IRN brenda intervalit T<sub>3</sub>.

*Shënime:*

*Në qoftë se parametri “Kodi i rrugëzimit” në mesazhin NIR ka një vlerë të paracaktuar (RN=9900), kjo do të thotë se numri respektiv i përket një serie numerike për përdorimin e së cilës është autorizuar OM dhe për pasojë OM është kthyer në ODhF. Numri respektiv duhet të fshihet nga DBR. Në qoftë se pjesa tjetër e operatorëve marrin këtë mesazh, ato duhet të fshijnë informacionin e këtij numri të bartur nga DBROp-të e tyre.*

### 3.6. PROCESI I SINKRONIZIMIT

Procesi i sinkronizimit siguron se informacionet e rrugëzimit në DBROp-të e secilit operator janë gjithmonë të përditësuar në lidhje me numrat e bartur. Zakonisht DBROp-të janë përditësuar në bazë të informacionit të dërguar nga DBRC-ja ndërmjet mesazheve PIR, mesazheve të fshirjes (FIR) ose ndërmjet mesazheve modifikuese të informacionit bazë (NIR) përmendur në proceset respektive. Procesi i Sinkronizimit ka si qëllim:

1. të lejojë një operator të marrë një informacion të humbur lidhur me një numër të bartur, një informacion për një interval kohe të caktuar, ose informacion për të gjithë numrat e bartur;
2. të lejojë një operator të ri të sinkronizohet me statusin aktual të DBRC-së.

#### 3.6.1. NËNPROCESI KËRKIMIT

Një operator mund të kërkojë nga DBRC informacion lidhur me një numër të caktuar, duke dërguar mesazhin KKO. DBRC i përgjigjet kësaj kërkesë duke dërguar një kopje të informacionit të përditësuar në DBR, bazuar në mesazhin e fundit të përditësimit të dërguar lidhur me numrin respektiv (PIR). Shkëmbimi i mesazhit ndodh në kohë reale.

Mesazhet e dërguara gjata këtij nënprocesit janë si më poshtë:

- KKO** - kontroll i kërkuar nga operatorët: mesazhi i dërguar nga operatori tek DBRC, duke specifikuar grupin e informacionit të cilin operatori do të kontrollojë;
- P<sub>DBRC</sub>** – përgjigje e DBRC-së.

Diagrama 7 ilustron shkëmbimin e mesazheve të ndodhur gjatë nënprocesit të kontrollit të një numri.



**Diagrama 7**


#### 3.6.2. NËN PROCESI I SINKRONIZIMIT TOTAL OSE TË PJESSHËM

Procesi i sinkronizimit total ose të pjesshëm është i nevojshëm në qoftë se një operator i ri ose një operator ekzistues baza e të dhënave e të cilit është shkatërruar pjesërisht (në një periudhë të caktuar) osë plotësisht kërkon një kopje të të dhënave nga DBRC. Operatori mund të kërkojë një kopje nga DBRC për të gjithë numrat e bartur ose për numrat e bartur gjatë një kohe të caktuar. Operatori i dërgon DBRC mesazhin KIS. Përgjigja DBRC ( $P_{DBRC}$ ) duhet të specifikojë mënyrën dhe momentin e dërgimit të informacionit të nevojshëm. Sinkronizimi i bazave të të dhënave duhet të kryhet në momentin e dhënë në mesazhin  $P_{DBRC}$ . Informacioni mund të transmetohet, si një raport, në një format të dhënë, sipas marrëveshjes me operatorin respektiv (të ruajtur në një suport fizik, file transfer). Informacioni i përditësuar në DBRC (numri i bartur, numri i rrugëzimit, ID e marrësit, ID e dhënësit, data e bartjes) duhet të dërgohet siç janë aktualisht në DBR, pra duke pasqyruar çdo përditësim, modifikim apo fshirje në informacionin e rrugëzimit (PIR, NIR, FIR).

Mesazhet që dërgohen gjatë këtij procesi janë si më poshtë:

- KIS** - kërkesë për informacion të sinkronizuar: mesazhi i dërguar nga operatori tek DBRC, duke kërkuar një kopje të informacionit DBRC;
- $P_{DBRC}$**  - Përgjigja e DBRC.

Diagrama 8 ilustron shkëmbimin e mesazheve brenda nënprocesit të sinkronizimit të pjesshëm ose të plotë.



**Diagrama 8**

### 3.7. PROCESI I TRANSFERIMIT TE BLOQEVE TË NUMRAVE.

Në qoftë se AKEP transferon një bllok numrash që përmban numra të bartur nga një operator tek një operator tjetër i komunikimeve elektronike, operatori respektiv kthehet në një ODhF. AKEP duhet të informojë DBRC-në për transferimin e bllokut të numrave dhe duhet të publikojë këtë informacion në faqen web të tij.

Numrat e caktuar në bllokun e transferuar do të kenë një nga statuset e mëposhtme:

- a) bëhen numra jo të bartur, në qoftë se operatori tek i cili AKEP i ka transferuar është një OM për këto numra të bartur. Operatori i cili tani ka statusin e ODhF duhet të informojë DBRC-në për të gjithë numrat në bllokun e transferuar për të cilët ai jepte shërbime si një OM, dhe si rrjedhim këta numra kthehen në numra jo të bartur. Procesi i informacionit duhet të vazhdojë sipas procedurës për modifikimin e informacionit të rrugëzimit duket dërguar mesazhin NIR, ku parametri "Numri i Rrugëzimit" ka vlerë të paracaktuar (NR=9900);
- b) mbeten numra të bartur, në qoftë se bloku i numrave të transferuar përmban numrat të cilët janë bartur tek operatore të ndryshëm nga operatori i cili është mbajtësi i ri i bllokut të numrave. Të dhënat e referencës për këto numra (identiteti i ODhF) do të modifikohen.

Mesazhet e dërguara gjatë këtij procesi janë të ngjashme me ato të dërguara gjatë procesit të modifikimit të informacionit të rrugëzimit.

Diagrama 9 ilustron shkëmbimin e mesazheve gjatë procesit të transferimit të bllokut të numrave.




Diagrama 9

### 3.8. PROCESI I INFORMIMIT PËR STATUSIN E SISTEMIT

#### 3.8.1. STATUSI I NDËRFAQES TË SISTEMIT TË PORTABILITETIT TË NUMRIT TË OPERATORIT

Operatorët duhet t'i komunikojnë DBRC-së statusin funksional/jo funksional e sistemit të tyre të menaxhimit të procesit të bartjes. Gjithashtu, DBRC duhet të monitorojë funksionimin e ndërfaqeve me operatorët. Statusi jo funksional i sistemit të një operatori duhet ti komunikohet operatorëve të tjerë dhe duhet të jetë i dukshëm ndërmjet një ndërfaqeje grafike web.

DBRC duhet të regjistrojë periudhën jo funksionale të sistemit të operatorit dhe duhet të rishikojë termat e proceseve.

Gjatë këtij procesi mund të dërgohen mesazhet e mëposhtme:

**SOD** - Sistemi i operatorit me defekt: Mesazhi dërguar nga një operator duke lajmëruar DBRC-në për statusin jo funksional të sistemit. Ky mesazh mund të dërgohet nga operatorët edhe nëpërmjet një ndërfaqeje grafike web të ofruar nga DBRC.

**SOR** – Sistemi i operatorit i rregulluar : Mesazhi i dërguar nga operatori tek DBRC në mënyrë që të informojë për rregullimin e sistemit.

Diagrama 10 ilustron shkëmbimin e mesazheve gjatë procesit të informacionit të statusit të sistemit të një operatori.




Diagrama 10

### 3.8.2. STATUSI DBRC

DBRC duhet të realizojë një mekanizëm komunikimi në mënyrë që të informojë operatorët për statusin jo funksional/rregullimin e sistemit DBRC. DBRC duhet të lajmërojë paraprakisht operatorët për periudhat jo funksionale të planifikuara dhe për rikthimin e statusit funksional, me mesazhe specifike.

Kur këto mesazhe nuk mund të dërgohen, DBRC duhet të informojë operatorët me një mënyrë tjetër komunikimi (telefon, e-mail, fax).

DBRC duhet të realizojë një mekanizëm për rifillimin e proceseve te ndërprera për arsye të situatave të ndryshme.


Periudhat e mos funksionimit të DBRC-së duhet të regjistrohen nga DBRC-ja.

Mesazhet e dërguara gjatë këtij procesi janë si më poshtë:

**DBJF**- për DBRC jo funksionale

**DBF**- për DBRC funksionale

Diagrama 11 ilustron shkëmbimin e mesazheve gjatë procesit të informacionit të statusit të DBRC-së.



**Diagrama 11**

### 3.9. SITUATA PËRJASHTUESE

#### 3.9.1. SITUATA PËRJASHTUESE GJATË FAZËS SË VLERËSIMIT

- I. OM dërgon mesazhin KBO por nuk merr ndonjë përgjigje lidhur me kërkesën për bartje nga DBRC brenda intervalit të dhënë tek specifikimet e DBRC. Në këtë rast, OM ridërgon kërkesën për bartje.
- II. ODh nuk dërgon mesazhin PKB gjatë intervalit Tpritjes=24 ore. Në këtë rast, procesi i bartjes mund të vazhdojë. DBRC duhet të regjistrojë dhe sinjalizojë skadimin e intervalit. Me kalimin e afatit, DBRC e merr si të mirëqenë PKBA.
- III. DBRC nuk mund ti dërgojë OM-së mesazhin PKB gjatë intervalit Tpritjes. Në këtë rast DBRC duhet të ruajë mesazhin në radhë dhe ta dërgojë atë sa më shpejt. Gjithashtu, operatori mund t'i rikuperojë këto mesazhe duke aksesuar një funksion për mesazhet e humbura.
- IV. Në qoftë se OM në vijim të një procesi zinxhir bartje është ODhF, parametri "Kodi i Rrugëzimit", në mesazhin KBO nuk duhet të përmbajë një nga numrat e rrugëzimit të dhënë ODhF-së, por duhet të ketë një vlerë të paracaktuar (NR=9900).

#### 3.9.2. SITUATA PËRJASHTUESE GJATË FAZËS SE BARTJES

- I. ODh dërgon mesazhin SKDh para momentit (tbartjes). Në këtë situatë, DBRC e refuzon mesazhin, duke gjeneruar kodin e gabimit korrespondues, dhe ruan informacionin përkatës ne DBA
- II. OM nuk kryen bartjen brenda intervalit T<sub>2</sub>. Në këtë situatë, DBRC ruan informacionin e mos plotësimit ne kohe te procesit të bartjes nga OM përkatës ne DBA.
- III. Shërbimi nuk është funksional brenda intervalit T<sub>2</sub>, por ODh ka dërguar mesazhin SKDh.

OM dhe ODh duhet të bashkëpunojnë për të identifikuar arsyet që kanë penguar realizimin me sukses te procesit. OM duhet të informojë pajtimtarin për situatën e krijuar. OM mund të sigurojë një zgjidhje

provizore (OM të sigurojë shërbimin me anë të një numri provizor ose ODh të ndërpresë pjesërisht ose plotësisht shërbimin ndaj numrit për të cilin është kërkuar bartja) për dhënien e shërbimit ose të ndalojë procesin.

Rastet e kalimit të intervaleve  $T_2$  dhe  $T_3$  duhet të regjistrohen dhe duhet të përfshihen në raportet e gjeneruara nga DBRC.

- IV. DBRC nuk merr mesazhin që kërkon sinkronizimin e informacionit të rrugëzimit nga operatore të caktuar brenda intervalit  $T_3$ . Në këtë situatë, DBRC duhet të konsiderojë se informacioni i rrugëzimit për bartjen aktuale është aktivizuar nga të gjithë operatorët, por duhet të regjistrojë të gjithë operatorët të cilët nuk kanë realizuar sinkronizimin. Një listë e operatorëve të cilët nuk kanë sinkronizuar informacionin e rrugëzimit duhet t'i dërgohet OM-se.
- V. Në qoftë se OM është një ODhF (mbas një procesi bartje zinxhir), kodi i rrugëzimit për numrin duhet të ketë një vlerë të paracaktuar (NR=9900). Nga këndvështrimi i DBRC, ky kod tregon se numri i lëvizur është rikthyer tek ODhF-ja. Gjate sinkronizimit për të gjitha regjistrimet me kod rrugëzimi me vlerë të paracaktuar NR=9900, operatorët duhet të fshijnë informacionin e rrugëzimit nga DBROp e tyre për numrat përkatës dhe thirrja për tek këta numra do të realizohet si për numrat jo të bartur.

### 3.10. INTERVALET (AFATET) E KRYERJES SE PROCESIVE ADMINISTRATIVE TË LIDHURA ME ZBATIMIN E PORTABILITETIT TË NUMRIT

Nr.	Intervali	Përcaktimi	Kohëzgjatja
1.	$T_p$	Afati maksimal i përcaktuar për plotësimin e procesit të bartjes	3 ditë pune
2.	$T_{DBRC}$	Afati brenda të cilit DBRC duhet të analizojë mesazhin e marrë, të përgjigjet me një mesazh pranimi/refuzimi tek dërguesi dhe të ridërgojë mesazhin tek operatori i dhënës	Menjëherë (pak sekonda)
3	$t_0$	Koha kur DBRC merr kerkesen KBO nga OM	Momenti kur fillon proces i bartjes.
4	$t_{bartjes}$	Koha e sakte kur do të behet procesi i bartjes	vendoset nga DBRC
5	$DT_{bartjes}$	Afati maksimal për fillimin e procesit të bartjes	sipas pikës 2 neni 16 te RPN
6.	$DT_{vleresim}$	Afati maksimal brenda të cilit ODh duhet t'i përgjigjet një kërkesë duke dërguar mesazhin PKB	$DT_{vleresim} = t_0 - t_5$ Për operatorët me > 100000 pajtimtarë -për <=100 numra: <15min në 90% rasteve <24ore e 9min në 98% rasteve -per >100 numra: <3dite në 98% rasteve  Per operatoret me < 100000 pajtimtare -per <=100 numra: <6ore e 9min në 90% rasteve <3dite në 98% rasteve -per >100 numra:

			<5dite ne 98% rasteve
7.	T <sub>2</sub>	Afati maksimal brenda te cilit ODh duhet të kryejë aktivitet e duhura për shkëputjen e numrit. Afati fillon kur mesazhi FBN është dërguar dhe mbaron kur bartja është kompletuar nga ODh-ja (OM merr mesazhin SKDh)	Sipas nenit 12 të rregullores për Portabilitetin.
8.	T <sub>3</sub>	Afati maksimal brenda të cilit të gjithë operatorët duhet të përditësojnë informacionin e rrugëzimit, bashkë me transmetimin për në DBRC të mesazheve që tregojnë përditësimin e informacionit të rrugëzimit (PIR, FIR, NIR)	6 orë
9.	T <sub>kerkuar</sub>	Afati maksimal brenda të cilit bartja mund të kërkohet nga pajtimtari. Në qoftë se afati tejkalohet, DBRC refuzon kërkesën për bartje	90 ditë
10.	T <sub>4</sub>	Afati maksimal nga i cili mund të anulohet kërkesa për bartje	Vendoset nga DBRC, koha maksimale deri para fillimit te procesit të bartjes.
11.	T <sub>pasherbim</sub>	Afati maksimal gjatë të cilit pajtimtari mund të qendroje pa sherbim.	T <sub>pasherbim</sub> = t <sub>g</sub> - t <sub>6</sub> 24 orë (sipas pikes 2 neni 12 RPN)

*Shënime:*

- 1. Intervalet duhet te rillogariten nga DBRC nëpërmjet një mekanizmi automatik, duke marrë për bazë edhe periudhat e mosfunksionimit. Këto intervale duhet t'i komunikohen operatorëve të përfshirë nga DBRC-ja.*
- 2. Intervalet duhet të vendosen si ore, ditë kalendarike ose dite pune. Një ditë pune konsiderohet një ditë jave, nga e hënë deri të premte, përveç pushimeve zyrtare.*

#### **4. RREGULLAT PËR ORGANIZMIN DHE FUNKSIONIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE REFERENCË E CENTRALIZUAR (DBRC)**

##### **4.1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME**

Zbatimi dhe menaxhimi i portabilitetit të numrit kryhet nëpërmjet një sistemi informacioni, që përfshin bazën e të dhënave, hardware-et, software-et dhe pajisjet e komunikimit.

Ky sistem informacioni ruan dhe përpunon të dhënat si dhe mundëson komunikimin me sistemet e informacionit të operatorëve që marrin pjesë në procesin e portabilitetit. Ky komunikim duhet të realizohet nëpërmjet një



aplikacioni web të sigurt. Ndërsa, për publikun duhet të ofrohet informacion për numrat e bartur, nëpërmjet një faqeje interneti (website).

DBRC-ja mbledh dhe ruan të dhëna për numrat e bartur si dhe ju mundëson operatorëve shkëmbimin e informacionit gjatë procesit të bartjes. Komunikimi ndërmjet DBRC-së dhe DBLP-ve të operatorëve realizohet me anë të ndërfaqeve standarde dhe në mënyrë të sigurt. Informacioni i rrugëzimit që ruhet në DBRC përdoret nga operatorët për rrugëzimin e thirrjeve tek numrat e bartur.

DBRC mbart informacion lidhur me të gjithë kategoritë e numrave që mund të barten pjesë e PKN-së. Gjithashtu, DBRC i ofron AKEP-it të gjithë informacionin e nevojshëm për të verifikuar zbatimin e portabilitetit.

Ofruesi i bazës së të dhënave referencë të centralizuar (OfDBRC) është personi juridik i cili është i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, i zgjedhur nga AKEP për të ofruar bazën e të dhënave referencë të centralizuar, bazuar në pikën 15 të nenit 2 të rregullores për portabilitetin.


OfDBRC duhet të sigurojë funksionimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e DBRC-së për zbatimin e portabilitetit të numrit.

## 4.2. ARKITEKTURA E DBRC-SË

DBRC përbëhet nga dy komponentë kryesore:

1. Baza e të dhënave administrative (DBA), e cila përmban regjistrin e transaksioneve (procedura administrative) që realizohen ndërmjet operatorëve, si dhe informacione shtesë të nevojshme për zbatimin e portabilitetit. DBA mundëson shkëmbimin e mesazheve ndërmjet operatorëve si dhe ruajtjen e tyre.
2. Baza e të dhënave referenciale (DBR), e cila përmban të gjithë informacionin për numrat e bartur dhe numrat e rrugëzimit.

Skema për zbatimin e portabilitetit të numrit paraqitet në diagramën 12.



**DBRC** – Baza e të dhënave referencë e centralizuar  
**DBA** – Baza e të dhënave administrative  
**DBR** – Baza e të dhënave referenciale  
**DBAOp** – Baza e të dhënave administrative e operatorit  
**DBROp** – Baza e të dhënave referenciale e operatorit

**Diagrama 12**

Operatorët nuk do të përdorin DBRC-në në kohë reale për rrugëzimin e thirrjeve tek numrat e bartur. Operatorët duhet të mundësojnë rrugëzimin e thirrjeve ose mesazheve tek numrat e bartur duke përdorur DBROp.

Baza e të dhënave administrative e operatorit (DBAOp) përdoret nga operatorët për të komunikuar me DBRC-në për të realizuar portabilitetin e numrit. DBAOp merr nga DBR informacionin e rrugëzimit për numrat e bartur, e ruan këtë informacion dhe përditëson DBROp-në.

Të gjithë operatorët e origjinimit të thirrjeve (OoTh) duhet të kenë akses në informacionin e rrugëzimit të numrave të bartur, i ruajtur në DBRC. Operatorët përkatës mbajnë përgjegjësi për implementimin e "bazës së të dhënave lokale pasqyrë" (DBLP), e përbërë nga DBROp dhe DBAOp.

Komunikimi ndërmjet DBRC-së dhe operatorëve të përfshirë në zbatimin e portabilitetit të numrit (AKEP dhe OOTH-te) bëhet me anë të rrjetit VPN në adresa IP të sigurta ose linjave të dedikuara.

#### 4.3. FUNKSIONET E DBRC-SË

##### 4.3.1. INFORMATIZIMI I PROCESVEVE PËR ZBATIMIN E PORTABILITETIT TË NUMRIT

Aplikacioni software në DBRC duhet të zbatojë proceset administrative të portabilitetit të numrit në përputhje me specifikimet teknike. Për këtë qëllim, aplikacioni duhet të sigurojë shkëmbimin e mesazheve, në kohë reale, të transmetuara nga operatorët dhe anasjelltas, si dhe duhet të përditësojë të dhënat përkatëse.

Bazat e të dhënave të operatorëve duhet të përditësohen mbi bazën e informacionit të transmetuar nga DBRC-ja, me anë të mesazheve të përditësimit, fshirjes ose ndryshimit të informacionit të rrugëzimit. Gjithashtu, DBRC-ja duhet të sigurojë sinkronizimin e bazave të të dhënave të operatorëve, duke lejuar, me kërkesën e tyre, shkarkimin e informacionit të rrugëzimit të një numri të bartur, të gjithë numrave të bartur ose numrat e bartur në një periudhë kohe të caktuar.

Aplikacioni software duhet të ofrojë mekanizma të përshtatshme në mënyrë që:

- a) të trajtojë, në mënyrë individuale, kërkesat për bartje;
- b) të monitorojë dhe përditësojë informacionin për kapacitetin ditor të përpunimit të çdo ODh-je;
- c) të menaxhojë radhën e kërkesave të bartjes për 2 ditë pune (ditën e sotme dhe atë pasardhëse);
- d) të menaxhojë situatat përjashtuese që janë pjesë e proceseve administrative (të tilla si: ndërprerja e proceseve si rezultat i mosfunksionimit të DBRC-së ose aplikacioneve të operatorëve; dështimi i transmetimit të mesazheve në kohën e caktuar; përshtatja e afateve në përputhje me statusin e funksionimit, etj.).

Aplikacioni software duhet të ofrojë një mekanizëm për të informuar operatorët për përditësimin e kapacitetit të përpunimit, rillogaritjen e afateve etj.

##### 4.3.2. RUAJTJA DHE NDRYSHIMI I INFORMACIONIT TË RRUGËZIMIT

Për çdo numër të bartur, ruhet një regjistrim (record) në DBR (ndërsa transmetohet mesazhi PIR). Ky regjistrim do të përfshijë:

- a) (DN); Numrin e bartur
- b) (NR); Numrin e rrugëzimit
- c) Koha e bartjes (viti, muaji, data, ora);
- d) ID ODh;
- e) ID ODhF;
- f) ID OM.

Në qoftë se është e nevojshme, me kërkesën e operatorit, DBRC-ja duhet të replikojë të dhënat referenciale të ruajtura në DBRC, në mënyrë që të sigurojë sinkronizimin me DBLP të operatorit përkatës, sipas përcaktimeve të pikës 3.6. "Procesi i sinkronizimit".

##### 4.3.3. KUSHTE NË LIDHJE ME INFORMACIONIN E VLEFSHËM PËR PUBLIKUN

DBRC duhet të përfshijë një aplikacion web-i që duhet të:

- a) publikojë seritë e numeracionit që përmbajnë numrat e bartshëm;
- b) ofrojë një motor kërkimi, me anë të të cilit publiku mund të gjejë nëse një numër i caktuar është i bartur dhe nëse po, operatorin ku numri merr aktualisht shërbimin.

Nuk publikohen të dhënat personale të pajtimtarëve, të cilët marrin shërbime nga numrat e bartur.

Publiku duhet të vihen në dijeni që për të gjetur tarifat e thirrjeve tek numrat e bartur, duhet të kontaktohen ofruesit e shërbimit përkatës. Për këtë qëllim, aplikacioni duhet të mundësojë mënyrat e kontaktit dhe link-et e faqeve të internetit (websites) të operatorëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike të vlefshme për publikun që ofrojnë këtë shërbim.

Përdoruesit do të aksesojnë këtë aplikacion web me anë të një mekanizmi sigurie "anti-robot". Aksesimi i informacionit të vlefshëm për publikun nuk duhet të ndikojë sigurinë e DBRC-së dhe integritetin e të dhënave të DBRC-së.

#### 4.3.4. RAPORTET

DBRC gjeneron raporte standarde ose sipas kërkesës, duke bërë të mundur që këto raporte të printohen ose transferohen si një skedar i siguar. Kjo nuk duhet të ndikojë në performancën operacionale të DBRC-së.

Gjithashtu, DBRC mban një liste të përditësuar të raporteve të gjeneruara.

Në varësi të marrësit, raportet klasifikohen në :

- a) Raporte ekskluzive për AKEP-in

DBRC ofron instrumente ose mbështetje për AKEP-in, për të gjeneruar raporte mbi përdoruesit e DBRC-së.

- b) Raporte për operatorët dhe AKEP-in

Çdo operator (ODh ose OM) duhet të aksesojë ekskluzivisht raportet për numrat e bartur nga rrjeti i tyre ose anasjelltas. AKEP duhet të aksesojë të gjitha tipet e raporteve. Këto raporte duhet të gjenerohen në bazë ditore, mujore ose tremujore, në varësi të llojit të raportit.

Raportet standarde të gjeneruara nga DBRC përshkruhen në ANEKSIN 1, pjesë e këtyre termave teknike.

#### 4.4. AKSESIMI I DBRC-SË

Aksesimi nga operatorët i DBRC-së, duhet të sigurohet nëpërmjet ndërfaqeve administrative. Komunikimi realizohet me anë të mesazheve që përmbajnë informacion specifik. Protokolle i komunikimit duhet të sigurojë një mekanizëm për vlerësimin e integritetit të të dhënave të mesazhit.

DBRC duhet të përfshijë një software të tipit "web client" për dërgimin e mesazheve mbi proceset, në varësi të njëjës nga mënyrat e mëposhtme të transmetimit të zgjedhura nga përdoruesi:

- a) komunikim jo i automatizuar i bazuar në web(web-based);
- b) komunikim i automatizuar, bazuar në komunikimin direkt të DBRC me bazën e të DBAOp (M2M). Zgjidhja e komunikimit M2M nuk duhet të lejojë DBRC të ketë akses në sistemet e aplikacioneve të

operatorëve. Komunikimi mund të realizohet mbi protokollin SOAP me anë të transferimit të informacioneve në format XML.

DBRC-ja duhet të sigurojë operatorëve zgjidhje software që krijojnë mundësinë e komunikimit server-klient.

Operatorët që përdorin transmetim manual duhet të kenë:

- a) një web browser për dërgimin e mesazheve nga aplikacioni klient i DBRC-së;
- b) mekanizma të përshtatshëm sigurie;
- c) Lidhje IP

Operatorët që përdorin komunikim automatik duhet të kenë një paketë software që të mundësojë lidhjen automatike me DBRC-në për shkëmbimin e mesazheve XML mbi protokollin e zgjedhur të komunikimit.

#### 4.5. FUNKSIONI I FATURIMIT (BILLING)

Aplikacioni software duhet të lejojë zbatimin e funksionit të faturimit, nëse kërkohet, për faturimin e operatorëve për mbulimin e kostove të administrimit, operimit dhe mirëmbajtjes së DBRC-së.

#### 4.6. MONITORIMI I FUNKSIONIMIT TË DBRC-SË

DBRC mundëson:

- a) monitorimin e proceseve dhe rrjedhës së mesazheve;
- b) monitorimin e integritetit të të dhënave;
- c) monitorimin e ndërfaqeve dhe rrugëve të komunikimit.

#### 4.7. KËRKESAT PËR DBRC

##### 4.7.1. KËRKESAT PËR PROGRAMET APLIKATIVE

Aplikacionet software duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

1. të jenë të standardizuara;
2. komandat për realizimin e veprimeve të ofrohen nëpërmjet menuve;
3. në ndërfaqet e futjes së të dhënave fushat e detyrueshme (mandatory) të jenë të dallueshme;
4. mesazhet e gabimit të afishohen në format standard për të gjithë sistemin dhe në të njëjtën vendndodhje në ekran;
5. sistemi duhet të kontrollojë saktësinë e futjes së të dhënave sipas formateve të paracaktuara;
6. sistemi të ketë një mekanizëm vlerësimi për integritetin e të dhënave të mesazheve të shkëmbyera;
7. të përdoret një mekanizëm i automatizuar për menaxhimin e situatave përjashtuese;
8. të caktohen profile të ndryshme për operatorët dhe për OfDBRC;

##### 4.7.2. KËRKESA PËR AKSESIN E PËRDORUESVE NË DBRC

DBRC duhet të lejojë regjistrimin e përdoruesve, anulimin dhe ndryshimin e të dhënave të regjistruara, si dhe mundësinë për të përcaktuar profilin e tyre. Profili i përdoruesve duhet të përfshijë:

- a) mënyrën e aksesit tek DBRC-ja;
- b) grupin e të drejtave.

Duhet të aplikohen këto grupe të drejtash:

1. grupi I – OfDBRC-ja;
2. grupi II – në përdoruesit e këtij grupi kanë akses në DBRC për të gjitha proceset e lidhura me portabilitetin e numrit, në të cilat janë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë;
3. grupi III - përdoruesit e këtij grupi kanë akses vetëm në informacionin e rrugëzimit në DBRC;
4. grupi IV – AKEP-i. AKEP ka akses në të gjitha të dhënat statistikore të lidhura me ecurinë e zbatimit të portabilitetit të numrit.

---

#### 4.7.3. KËRKESA TE SIGURISË

DBRC duhet të sigurojë plotësimin e kërkesave të mëposhtme të sigurisë:

- a) përdoruesit duhet të aksesojnë DBRC-në vetëm duke u bazuar në metoda të sigurta të logimit;
- b) mënyra e logimit, ID-te dhe fjalëkalimet duhet të jepen nga administratori i sistemit. Fjalëkalimet fillestare duhet të shpërndahen tek përdoruesit në zarfe të vulosura;
- c) fjalëkalimet duhet të kenë të paktën 8 karaktere (karakteret alfanumerike dhe karaktere speciale);
- d) fjalëkalimet fillestare duhet të ndryshohen nga operatorët në sesionin e parë të logimit në aplikacionin e DBRC-së dhe duhet të ndryshohet në mënyrë periodike;
- e) duhet të kontrollohen të drejtat e aksesit, në rast të kërkesave të marrjes së raporteve, shkrimit ose leximit në DBRC;
- f) duhet të menaxhohen mesazhet e regjistruara (p.sh. verifikimi për çdo mesazh i origjinës së të dhënave, përgjigjes së mesazhit, modifikimit të mesazhit, intervalit kohor të mesazhit)
- g) sistemi duhet të kontrollojë origjinalitetin e të dhënave,
- h) ndërfaqja ndërmjet DBRC-së dhe bazës së të dhënave të operatorit duhet të sigurojë enkriptimin e të dhënave.

#### KONTROLLI I REGJISTRIMEVE

DBRC duhet të ofrojë mundësinë e kontrollit të veprimeve të përdoruesve duke siguruar të paktën ruajtjen e informacioneve të mëposhtme:

- a) mesazhet e fillimit ose përfundimit të lidhjes;
- b) të gjitha mesazhet e gabimit të gjeneruara nga sistemi;
- c) të gjitha mesazhet për ndryshimin e informacionit në DBRC;
- d) adresën IP të përdorur për aksesin;
- e) të gjitha ndryshimet e të drejtave të aksesit;
- f) aksesin e autorizuar ose të paautorizuar të llogarisë;
- g) kohën e realizimit të veprimit (log).

---

#### 4.7.4. KËRKESAT PËR PERFORMANCËN E DBRC:

- a) DBRC duhet të ketë një kapacitet ruajtjeje për të mbajtur të paktën 2 milionë numra të bartur si dhe të ofrojë mundësi për rritjen e kapacitetit të ruajtjes;
- b) DBRC duhet të ofrojë mundësinë e aksesimit të shërbimeve, të paktën nga 300 përdorues (operatorë) në të njëjtën kohë. Çdo operator duhet të ketë një pike akses (një emër përdoruesi, një fjalëkalim, një sesion të hapur);
- c) DBRC duhet të përputhet, të paktën, 6000 numra të bartur në dite;
- d) DBRC duhet të ruajë dhe interpretojë informacionin lidhur me shkëmbimin e mesazheve për një periudhë, të paktën, 10 vjeçare. Vetëm informacioni për 24 muajt e fundit duhet të jetë i aksesueshëm në mënyrë direkte. Për të dhënat me të hershme duhet ofrohet një procedurë aksesimi e cila nuk ndikon në performancën operacionale të DBRC-së.

---

#### 4.7.5. KËRKESAT PËR BESUESHMËRINË DHE DISPONUESHMERINË

DBRC si dhe DBLP-të duhet te përmbushin kërkesat e **besueshmërisë dhe disponueshmërisë**, si më poshtë:

- a) DBRC dhe DBLP duhet të funksionojnë 24 orë në ditë në të gjitha ditët e vitit.;
- b) Disponueshmëria e të gjitha funksioneve të DBRC-së dhe DBLP-ve duhet të jetë të paktën 98.5% llogaritur gjatë vitit kalendarik;
- c) Afati kohor i lejuar për te riparuar sistemin, pas ndonjë defekti të lehte nuk duhet të kalojë 1 orë (nga momenti i raportimit të defektit deri në rikuperimin e plotë të sistemit);
- d) Afati kohor i lejuar për te riparuar sistemin, pas ndonjë defekti të rende nuk duhet të kalojë 8 orë (nga momenti i raportimit të defektit deri në rikuperimin e plotë të sistemit);
- e) DBRC duhet të ofrojë një mekanizëm informues për operatorët, në rast keqfunksionimi apo mosfunksionimi;
- f) DBRC duhet të ofrojë një mekanizëm procesimi të veprimeve të prekura nga keqfunksionimi i DBRC-së.

DBRC duhet të ofrojë raporte për të monitoruar performancën e saj si dhe të DBLP-ve, në lidhje me kërkesat e mësipërme.

---

#### 4.7.6. BACK-UP, RIKUPERIMI DHE RIKUPERIMI PAS NJË FATKEQËSIE.

DBRC duhet te përmbushë kërkesat e mëposhtme:

- a) te parashikojë procedura back-up-i për të siguruar një version të përditësuar me të dhëna funksionale të DBRC-së;
- b) te parashikojë procedura të automatizuara rikuperimi, në rastet të humbjes së të dhënave (data loss);
- c) te parashikojë procedura të automatizuar back-up-i për DBR dhe DBA të cilat mund të realizohen në intervale të caktuara kohe;
- d) te gjitha të dhënat e nevojshme për rikuperimin e sistemit duhet të mbahen të replikuara në 2 vendndodhje të ndryshme gjeografike për të minimizuar problemet në rast avarie apo defektesh teknike.
- e) procedurat e back-up-it, rikuperimit të sistemit dhe rikuperimit të veprimeve mbas fatkeqësive (disasters) duhet të dokumentohen.

Në rast të një fatkeqësie (disaster) që kufizon kapacitetin funksional të DBRC-së, duhet të mundësohet vënia në funksionim të plotë të saj, brenda 48 orëve. Ky kusht vlen edhe për DBLP-të.

---

#### 4.7.8. MODULET E TESTIMIT

DBRC duhet ofrojë module testimi të posaçme, për të testuar lidhjet (connections) dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet DBRC-së dhe përdoruesve. Kushtet e testimit duhet të jenë të ngjashme me kushtet reale të funksionimit të DBRC dhe operatorëve.

---

#### 4.7.9. MONITORIMI I FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT.



Për të siguruar integritetin e të dhënave dhe sistemit (mirëmbajtja e të dhënave), DBRC duhet të përfshijë procedurat e mëposhtme:

- a) Procedurat për monitorimin e burimeve të sistemit (duke përfshirë burimet hardware);
- b) Procedurat për kontrollin e integritetit të bazës së të dhënave;
- c) Procedurat për zbulimin e kushteve të gabimeve;
- d) Rregulla për kontrollin e përditësimit të të dhënave;
- e) Procedura për sinkronizimin e kohës së sistemit, duke siguruar sinkronizimin e DBRC-së dhe DBLP-ve duke përdorur protokollet e duhura.

Për monitorimin të linjave të komunikimit me DBRC-në, sistemi duhet të sigurojë:

- a) Zbulimin e gabimeve të komunikimit;
- b) Asistencë në zgjidhjen e problemeve të komunikimit të të dhënave ndërmjet DBLP-ve dhe DBRC-së;
- c) Kontrollin e vazhdueshëm për statusin funksional/jo funksional të sistemit të operatorëve.

---

#### 4.7.10. RITJË E KAPACITETEVE DHE RINOVIMI (SCALABILITY & UPGRADING)

DBRC duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

- a) përshtatjen e regjistrimeve (records) në mënyrë që të lejohet shtimi ose modifikimi i tipit të mesazheve të përpunuar nga sistemi.
- b) procedurat e rinovimit (upgrade) dhe të rritjes së kapaciteteve të sistemit duhet të kenë një ndikim minimal në ndërprerjen e funksionimit të tij. Në përgjithësi, këto veprime duhet të kryhen gjatë ndërprerjeve të parashikuara.

---

#### 4.7.11. MIRËMBAJTJA, TRAJNIMI DHE ASISTENCA TEKNIKE

Ofruesi i sistemit duhet të sigurojë:

- a) Garantimin e operimit të përhershëm të DBRC-së përgjatë gjithë kohës së kontratës me AKEP dhe pas saj;
- b) Dokumentacionin teknik të plotë lidhur me DBRC-në;
- c) Dokumentacionin e testimit;
- d) Programe asistencë (ndihmë on-line);
- e) Programe trajnimi për përdorimin e DBRC-së.

#### 4.8. ROLI I OFDBRC-SË

OfDBRC ka funksionet e mëposhtme:

- a) të implementojë DBRC-në.
- b) të menaxhoje dhe monitoroje DBRC-në ;
- c) të planifikojë dhe zbatojë politikat e back-up-it për të siguruar mbrojtjen e të dhënave ;
- d) të ofrojë siguri për aplikacionet dhe të dhënat e DBRC-së ;
- e) të konfigurojë bazën e të dhënave dhe aplikacionet sipas kërkesave të sigurisë së operatorëve.
- f) të monitorojë proceset e aplikacionit;
- g) të monitorojë DBRC-në për sa i përket performancës dhe kapacitetit;
- h) të shqyrtojë problemet e ngritura nga përdoruesit e aplikacionit;
- i) të asistojë përdoruesit në rast defektesh;

#### 4.9. TË DREJTAT E OFDBRC-SË

##### 4.9.1. REGJISTRIMI/NDRYSHIMI/ANULLIMI I REGJISTRIMIT TË PËRDORUESIT

OfDBRC duhet të regjistrojë, ndryshojë ose anullojë regjistrimin e përdoruesve, bazuar në kërkesat e marra dhe në varësi të informacionit të procesuar të përcaktojë grupin të cilit i përket çdo përdorues (krijim profili).

Për t'u regjistruar në DBRC, të gjithë kërkuesit duhet t'i dërgojnë OfDBRC-së të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin e kërkuesit dhe të dhëna kontakti (person kontakti, numër telefoni, adrese e-mail-i);
- b) ID-në e operatorit;
- c) të dhënat e përdoruesit (OM, ODh, OT) në mënyrë që të përcaktohet klasa e aksesit ;
- d) mënyrën e aksesit (automatike ose manuale) dhe të dhënat e komunikimit (p.sh. adresën IP) ;
- e) numrin e telefonit dhe adresën e faqes së internetit (website-it) ku ndodhet informacioni për procedurën e bartjes dhe sipas rastit edhe tarifat e thirrjeve drejt numrave të bartur ;
- f) Seritë e numrave të autorizuar me një AIPN dhe që mund të barten, sipas rastit;
- g) Numrat e rrugëzimit të dhëna nga AKEP-i, sipas rastit.

Mbi bazën e informacionit të marrë nga AKEP-i, OfDBRC-së duhet të përcaktojë grupin e aksesit të cilit i përket.

OfDBRC duhet të lajmërojë përdoruesit për aktivizimin e llogarisë së tyre së bashku me të dhënat e mëposhtme:

- adresën e komunikimit me DBRC (website-in ose adresën IP) ;
- detajet e llogarisë për hyrje në DBRC( ID, password) ;

- të dhëna kontakti te OfDBRC-së (person kontakti, numër telefoni, adrese e-mail-i).

---

#### 4.9.2. SIGURIMI I FUNKSIONIMIT TE VAZHDOESHËM TE DBRC-SË

OfDBRC duhet të sigurojë funksionimin e DBRC-së duke monitoruar atë dhe duke marrë të gjitha masat e nevojshme për të zgjidhur problemet që mund të shfaqen gjatë funksionimit të saj.

OfDBRC duhet të përgatisë udhëzues për përdoruesit e DBRC-së (e përfshirë edhe në website), dhe të organizojë sesione trajnimi, sipas kërkesave të përdoruesve.

OfDBRC duhet të koordinojë dhe të asistojë përdoruesit për:

- a) testimin e funksionimit të DBRC-së për çdo përdorues, sa here që një përdorues i ri regjistrohet dhe sa here mund të ndodhë një defekt;
- b) korrigjimin e gabimeve që mund të ndikojnë në funksionimin e DBRC-së ;
- c) zgjidhjen dhe analizimin e problemeve të ndodhura nga shkarkimi i skedarëve.

OfDBRC duhet të lajmërojë të gjithë përdoruesit për ndërprerjet e parashikuara përpara se ato të ndodhin, me anë të një mesazhi elektronik. Nëse është i pamundur dërgimi i mesazhit, atëherë lajmërimi duhet të bëhet me telefon ose fax.

OfDBRC duhet të sigurojë rikuperimin e të dhënave të DBRC-së duke përdorur burimet e back-up-it si më poshtë:

- a) me kërkesë të përdoruesve të DBRC-së ose në rast defekti, OfDBRC duhet të fillojë kontrollin e të dhënave dhe procedurat për përditësim;
- b) gjatë këtij procesi, nëse operatorët përpiqen të aksesojnë DBRC-në, ata duhet të lajmërohen se po zhvillohen procese të back-up-it.
- c) gjatë këtij procesi, kërkesat për bartje të marra nga operatorët, mund të mos procesohen ;
- d) kërkesat për bartje të dërguara gjatë procedurave të back-up-it duhet të procesohen automatikisht sapo të përfundojë ky proces.

OfDBRC duhet të lajmërojë përdoruesit për versionet e software-it të DBRC-së që duhet të instalojnë.

Dokumentacioni i përditësuar duhet të përfshihet si pjesë e përditësimeve(update) të software-it. Po ashtu OfDBRC duhet të njoftojë përdoruesit për ndryshimet e DBRC-së.

---

#### 4.9.3. MBËSHTETJA ADMINISTRATIVE E NEVOJSHME PËR OPERIMIN E DBRC-SË

OfDBRC duhet të sigurojë:

- a) personelin dhe materialet e nevojshme për operimin e DBRC-së;
- b) menaxhimin e burimeve financiare;
- c) planin e aktivitetit për personelin e DBRC-së;
- d) ndihmën për operatorët (Help-Desk), e disponueshme gjatë orarit të rregullt të punës,ose nëse nevojitet, ky shërbim mund të jetë i disponueshëm 24 ore në 24, çdo dite të javës;
- e) pajisjet për DBRC-në dhe mirëmbajtjen e tyre;

f) pajisjet për komunikim:

1. mjetet për komunikim të dhënash (e-mail, website);
2. mjetet për komunikimin zanor, telefon fiks dhe të lëvizshëm;
3. aparaturat e fax-it.

---

#### 4.9.4. SIGURIA

OfDBRC duhet të vendose rregulla sigurie në lidhje me aksesimin e DBRC-së. Gjithashtu:

- a) vendndodhja e DBRC-së duhet të sigurohet duke krijuar pika aksesit (access points) dhe hapësira të mbrojtura të izoluar mirë ;
- b) Duhet të sigurohet mbrojtje fizike e pajisjeve për ruajtjen e informacionit dhe suportin.

---

#### 4.9.5. KONFIDENCIALITETI

Gjatë operimit, OfDBRC duhet të garantojë konfidencialitetin e të dhënave në përputhje me dispozitat ligjore:

- a. mbi informacionin e klasifikuar;
- b. mbi procesimin e informacioneve personale dhe mbrojtjen e fshehtësisë në sektorin e komunikimit elektronik.
- c. mbi mbrojtjen e të dhënave personale.

Përveç OM dhe ODh, asnjë përdorues tjetër nuk duhet të ketë akses në të dhënat që nuk ka lidhje me procesin e rrugëzimit të numrave të bartur të përdorur nga DBRC gjatë bartjes.

---

#### 4.9.6. DISPOZITAT PËR SHËRBIMET E OFRUARA NGA OFDBRC PËR PËRDORUESIT.

OfDBRC duhet të ofrojë një grup shërbimesh për përdoruesit, në varësi të grupit dhe zgjidhjes së bërë nga çdo operator. Këto shërbime duhet të ofrohen në bazë të kontratave të nënshkruara mes OfDBRC-së dhe përdoruesve.

Deri në emërimin e OfDBRC-së, ky rol do të kryhet nga AKEP-i. Në momentin e emërimit të OfDBRC-së, do të vendoset dhe zgjidhja financiare për menaxhimin, operimin dhe mirëmbajtjen e DBRC-së.

## 5. PARAMETRAT E CILËSË PËR DHËNIEN E SHËRBIMIT TË PORTABILITETIT TË NUMRIT

### 5.1. TË PËRGJITHSHME

Në këtë kapitull përcaktohen parametrat e cilësisë që duhet të mbikqyren gjatë procesit të bartjes në lidhje me shërbimin e portabilitetit të numrit.

Parametrat e cilësisë janë të lidhur me veprimet e kryera nga operatorët e shërbimeve telefonike të cilët kanë detyrimin për sigurimin e portabilitetit të numrit si dhe veprimet e OfDBRC.

Grupi i parametrave të cilësisë dhe objektivat specifike për këto parametra janë dhënë për:

- të siguruar zhvillimin pa probleme të procesit të bartjes
- te vlerësuar realizimin e detyrimeve që kanë operatorët e shërbimeve telefonike lidhur me implementimin e portabilitetit të numrit.
- të vlerësuar realizimin e detyrimeve të vëna mbi OfDBRC
- të siguruar terma referencë për vënien e marrëdhënieve kontraktuale ndërmjet operatorëve të përfshirë në implementimin e portabilitetit të numrit.
- të krijuar mundësinë që AKEP të monitorojë ndikimin e zbatimit të portabilitetit të numrit dhe të identifikojë problemet në zhvillimin e këtij procesi
- të krijuar mundësinë që AKEP duhet të kryejë analiza statistike.

### 5.2. PËRKUFIZIMI I PARAMETRAVE TË CILËSISË

#### 5.2.1. PARAMETRAT E CILËSISË TË PROCESIT TË BARTJES

##### I. NIVELI I KËRKESAVE PËR BARTJE TË TRANSMETUARA NË MËNYRË KORREKTE (RCC)

Ky parametër përfaqëson raportin, e shprehur në përqindje, ndërmjet numrit të kërkesave për bartje që janë konsideruar si korrekte nga DBRC (për të cilat DBRC ka dërguar mesazhin  $A_{CPF}$ ) dhe numrin total të kërkesave të transmetuara nga OM tek DBRC (CPF).

$$RCC[\%] = \frac{\text{Numri\_i\_kërkesave\_te\_pranuara}}{\text{Numri\_total\_i\_kërkesave\_te\_transmetuara}} \times 100$$

Ky parametër llogaritet për çdo OM dhe për çdo kategori të numrave të bartshëm.

##### II. NIVELI I KËRKESAVE TE PRANUARA PËR BARTJE (RCA)

###### 1. Niveli i kërkesave për bartje transmetuar nga një OM dhe pranuar nga të gjithë ODh (RCAOM).

Ky parametër përfaqëson raportin, e shprehur në përqindje ndërmjet numrit të kërkesave për bartje të pranuar nga ODh (për të cilën është dërguar mesazhi ACP) dhe numrit total të kërkesave të transmetuara nga një OM dhe të dërguara nga DBRC tek ODh-te.

$$RCA_{OM}[\%] = \frac{\text{Numri\_i\_kërkesave\_te\_pranuara\_nga\_te\_gjithë\_ODh}}{\text{Numri\_total\_i\_kërkesave\_te\_transmetuara\_nga\_OM\_dhe\_pranuar\_nga\_DBRC}} \times 100$$

Ky parametër llogaritet për çdo OM dhe për çdo kategori të numrave të bartshëm.

## 2. Niveli i kërkesave për bartje dërguar nga të gjithë OM dhe pranuar nga një ODh. (RCAODH)

Ky parametër përfaqëson raportin, e shprehur në përqindje, ndërmjet numrit të kërkesave për bartje të pranuar nga një ODh dhe numrit të kërkesave të marra nga OM (nëpërmjet DBRC).

$$RCA_{ODH}[\%] = \frac{\text{Numri\_i\_kërkesave\_te\_pranuara\_nga\_ODh}}{\text{Numri\_total\_i\_kërkesave\_te\_marra}} \times 100$$

Ky parametër llogaritet për çdo ODh dhe për çdo kategori të numrave të bartshëm.

## III. NIVELI I KËRKESAVE PËR BARTJE TE ANULLUARA (RKSAPN)

Ky parametër përfaqëson raportin, të shprehur në përqindje, ndërmjet numrit të kërkesave për bartje të dërguar nga një OM që janë anuluar nga DBRC dhe numrit total të kërkesave të dërguara nga OM-ja dhe pranuar nga ODh-ja.

$$RKSAPN[\%] = \frac{\text{Numri\_i\_kërkesave\_te\_anulluara}}{\text{Numri\_total\_i\_kërkesave\_te\_transmetuara\_nga\_një\_OM\_dhe\_nga\_te\_gjithe\_ODh}} \times 100$$

Ky parametër llogaritet për çdo OM dhe për çdo kategori të numrave të bartshëm.

## IV. NIVELI I KËRKESAVE PËR BARTJE TE PËRPUNUARA BRENDA INTERVALIT $DT_{VLERESIM}$ (RCPTVLERESIM)

Ky parametër përfaqëson raportin, të shprehur në përqindje, ndërmjet numrit të kërkesave për bartje për të cilat ODh përgjigjet brenda intervalit  $T_1$  dhe numrit total të kërkesave të marra nga ODh.

$$RCP_{DTVLERESIM}[\%] = \frac{\text{Numri\_i\_kërkesave\_te\_pranuara\_ose\_refuzuara\_në\_DTVLERESIM (ODh)}}{\text{Numri\_total\_i\_kërkesave\_te\_marra\_nga\_ODh}} \times 100$$

Ky parametër llogaritet për çdo ODh dhe për çdo kategori të numrave të bartshëm.

## V. NIVELI I KËRKESAVE PËR BARTJE E ZGJIDHUR NGA ODH BRENDA INTERVALIT $T_2$ . (RCPT2)

Ky parametër përfaqëson raportin, e shprehur në përqindje, ndërmjet numrit të kërkesave për bartje për të cilën ODh plotëson procesin e bartjes brenda intervalit  $T_2$  dhe numrit total të kërkesave të pranuar nga ODh.

$$RCPT_2[\%] = \frac{\text{Numri\_i\_kërkesave\_me\_bartje\_te\_realizuar\_në\_T_2(ODh)}}{\text{Numri\_total\_i\_kërkesave\_te\_pranuara\_nga\_ODh}} \times 100$$

Ky parametër llogaritet për çdo ODh dhe për çdo kategori të numrave të bartshëm.

## VI. NIVELI I KËRKESAVE PËR BARTJE ZGJIDHUR NGA OM BRENDA INTERVALIT $T_3$ (RCPT3)

Ky parametër përfaqëson raportin, e shprehur në përqindje, ndërmjet numrave të kërkesave për bartje për të cilat një operator ka realizuar përditësimin e DBROp brenda intervalit  $T_3$  me numrin total të kërkesave për përditësim të informacionit bazë të marrë nga DBRC.

$$RCP_{T3}[\%] = \frac{\text{Numri i kërkesave për të cilat operatori ka përditësuar DBROp.}}{\text{Numri total i kërkesave për përditësim të informacionit bazë të marrë nga DBRC}} \times 100$$

Ky parametër është llogaritur për çdo OM dhe për çdo kategori të numrave të bartshëm.

### 5.2.3. PARAMETRAT E CILËSISË TË DBRC

Parametrat e mëposhtme duhet të mbikqyren në mënyrë që të bëhet kontrolli i veprimeve për DBRC:

#### I. DISPONUESHMËRIA E DBRC- KOHA MESATARE E FUNKSIONIMIT TE DBRC, SHPREHUR NË PËRQINDJE, NË PERIUDHËN E MATJES.

Specifikimet në matjen e parametrave të treguesit.

$$\text{Disponueshmëria[\%]} = \frac{365 \cdot 24 \cdot 60 - \sum T_n}{365 \cdot 24 \cdot 60} \cdot 100$$

**T<sub>n</sub>** – Periudha kur DBRC nuk funksionon (në minuta).

Periudhat gjatë të cilës DBRC nuk funksionon janë konsideruar të jenë periudhat kur:

- U regjistruan defekte nga operatorët dhe u konfirmuan nga testet dhe investigimet;
- DBRC sinjalizon funksionim të pasaktë, i cili i konfirmua nga testet dhe investigimet;
- Ndodh ndërprerje e planifikuar (teste, mirëmbajtje, dhe aktivitete riparimi).

#### II. KOHA MAKSIMALE E RIPARIMIT PAS NJË DEFEKTI TE LEHTE- PERIUDHA KOHORE MAKSIMALE NGA MOMENTI I SINJALIZIMIT TË NJË DEFEKTI TE LEHTE DERI NË RREGULLIMIN E TIJ.

**Defekt i lehte**- një defekt i vogël që ndikon kapacitetin e procesit tek DBRC. Në këtë rast mesazhet duhet të procesohen në bazë të nivelit të prioritetit.

#### III. KOHA MAKSIMALE E RIPARIMIT PAS NJË DEFEKTI TE RENDE PERIUDHA MAKSIMALE E KALUAR NGA MOMENTI I SINJALIZIMIT I NJË DEFEKTI TE RENDE DERI NË RIPARIM E TIJ.

**Defekt i rende** - një defekt teknik që ndikon module të shumta të sistemit DBRC, përfshirë hardware, dhe që çon në pamundësinë e përdorimit të sistemit DBRC nga operatorët.

Operatori DBRC dhe OfDBRC duhet të identifikojnë defektet e lehta dhe defektet e rënda, si dhe modalitetit për ti rregulluar ato.

### 5.3. OBJEKTIVAT PËR CILËSINË E PROCESEVE TË BARTJES DHE OPERATORËT PËRGJEGJËS

Niveli i transmetimi të saktë të kërkesave për bartje

Parametri	Objektiva	Përgjegjës	Shënime
RCC[%]	70% - tremujori i parë* 80% - tremujori i dytë** 95%	OM	Do të numërohen të gjitha kërkesat për bartje

RCAOM[%] dhe RCAODH[%]	70% - tremujori i parë* 80% - tremujori i dytë** 95%	OM dhe ODh	Do te numërohen të gjitha kërkesat për bartje
RKSAPN[%]	5%	OM	Do te numërohen të gjitha kërkesat për bartje
RCPTVLERESIM [%]	80% - tremujori i parë* 95%	ODh	Do te numërohen vetëm kërkesat për bartje te zgjidhura
RCPT3[%]	80% - tremujori i parë* 95%	OT	Do te numërohen vetëm kërkesat për bartje te zgjidhura
Diponueshmëria[%]	98.5%	DBRC	
Koha maksimale për riparim Defekt i lehte	1 ore	DBRC	
Koha maksimale për riparim Defekt i rende	8 ore	DBRC	

*Shënim : (\*)-tremujori i parë pas daljes komerciale të portabilitetit të numrit.  
(\*\*)-tremujori i dytë pas daljes komerciale të portabilitetit të numrit.*

## 5.4 METODA MATËSE

Parametrat e cilësisë duhet te maten nga DBRC mbi bazë tremujore, për çdo operator, si ODh ashtu edhe OM.. Parametrat lidhur me DBRC duhet te maten mbi bazë vjetore, për vitin kalendarik te kaluar.

Vlerat e llogaritura për parametrat e cilësisë, për të gjithë operatorët, duhet t'i komunikohen AKEP. Vlerat e llogaritura për çdo operator duhet ti komunikohen operatorit respektiv. DBRC duhet te komunikojë vlerat e parametrave cilësor brenda 10 ditëve nga mbarimi i çdo tremujori.

Periudhat duhet te maten në bazë te parimeve të mëposhtme:

- Çdo rast i matur duhet te llogaritet bazuar në momentin e plotësimit (p.sh. një kërkesë dërguar nga OM me 31 Mars, për të cilën ODh përgjigjet me 1 Prill, duhet te numërohet për tremujorin e dytë);
- për parametrat e procesit të bartjes, pushimet nuk duhen numëruar (p.sh. intervali E Premte-E Hënë numërohet për 1 ditë);
- për disponueshmërinë e bazës së të dhënave, duhet te numërohen ditët kalendarike.

## 6. METODAT E INFORMIMIT TE PËRDORUESIT

### 6.1. PËRSHKRIM

Portabiliteti i numrit është një shërbim i ri i ofruar për klientët e operatorëve që ofrojnë shërbime telefonike. Zbatimi i këtij shërbimi ndikon te të gjithë përdoruesit e shërbimit telefonik.

Zbatimi me sukses është i lidhur me mekanizmin e saktë për sigurimin e transparencës të procesit të bartjes dhe te tarifave lidhur me portabilitetin e numrit.

Nevoja për informacion vjen si nga ana e pajtimtarëve që kërkojnë bartjen e numrit, të cilët duhet të jenë te qarte për kushtet në të cilat mund te përfitojnë nga ky shërbim, ashtu edhe nga përdoruesit e tjerë të shërbimeve telefonike, të cilët duhet te dine tarifat për thirrjet kundrejt numrave të bartur.



Informacioni duhet të jetë i vlefshëm për klientët (pajtimtarët), në mënyrë që këta të dine kushtet nga të cilat detyrimi për dhënie informacioni, është i vlefshëm si për operatorët të cilët e ofrojnë këtë shërbim, ashtu edhe për operatorët të cilët origjinojnë thirrje drejt numrave të bartur, pavarësisht se nuk e ofrojnë shërbimin.

Operatorët e shërbimeve telefonike kanë detyrimin për të bërë të disponueshëm kundrejt përdoruesve, sipas kërkesës dhe pa pagese, informacion të detajuar të shërbimit të portabilitetit të numrit, përfshirë tarifën e faturuar për dhënie të shërbimit dhe për thirrjet tek numrat e bartur, si me shkrim (web site) ashtu edhe nëpërmjet shërbimit të kujdesit për klientin.

## 6.2. INFORMIMI I PAJTIMTARËVE PËR PROCESIN E BARTJES TË NUMRIT

Informacioni mbi shërbimin e portabilitetit të numrit duhet të ofrohet nga çdo OM gjatë procedurës për vlerësimin e kërkesës për bartje.

Duhet të përdoret informacioni i më poshtëm:

- a. Shërbimi për klientin, pa pagese, në lidhje me kushtet e specifikuar në pikën 7.3;
- b. Publikimi, në vende të dukshme ose bërja publike tek premiset komerciale të operatorit, transmetimi me shkrim-sipas kërkesës dhe pa pagese- kërkesa për bartje si dhe procedura për vlerësimin e kërkesës për bartje dhe publikimi në web site të OM-se.

Operatorët e shërbimeve telefonike të cilët nuk japin shërbime telefonike, por përfitojnë nga e drejta e përdorimit të serive numerike të dhënë nga APN, duhet të kenë detyrimin të informojnë klientët e tyre në faktin se ato nuk ofrojnë shërbimin e portabilitetit të numrit.

## 6.3. INFORMIMI I PËRDORUESVE NË TARIFAT E NDRYSHUARA PËR THIRRJET TEK NUMRAT E BARTUR

Deri tani, operatorët e shërbimeve telefonike faturojnë tarifa të ndryshme bazuar në tipet e shërbimeve të thirrjes, në tipin e rrjetit ndërmjet të cilës bëhet thirrja (publik fiks ose publike e lëvizshme), si dhe në rrjetin në të cilin thirrja është terminuar (thirrja e terminuar në rrjetin origjinal ose jashtë rrjetit)

Ky mekanizëm i ofron telefonuesit mundësinë për të thirrur numrat e caktuar me një shërbim të caktuar dhe me një operator shërbimi të caktuar (ose me një rrjet të caktuar), duke siguruar transparencën e tarifave. Ky fakt është shumë i rëndësishëm për shërbimet telefonike, ku tarifa e një telefonate në të njëjtin rrjet është zakonisht me e ulët se në rrjete të tjera, por mund të jetë gjithashtu me e rëndësishme për shërbimin telefonik fiks.

Mbas zbatimit të portabilitetit të numrit, asnjë numër nuk mund të lidhet me një operator të caktuar të shërbimit telefonik.

Metoda e faturimit duhet të zgjidhet nga operatori i cili bën thirrjet.

Pavarësisht metodës së zgjedhjes, operatorët që bëjnë thirrje kanë obligimin për të bërë të disponueshme tek përdoruesit informacionin lidhur me:

- a. OM - operatorin i cili ofron shërbimet ndërmjet një numri të bartur ;
- b. Tarifën për një thirrje tek një numër i bartur.

Informacioni duhet të bëhet i disponueshëm pa pagese tek përdoruesit me anë të shërbimit për klientin, me shkrim dhe duke e publikuar në website-in e operatorit. Operatorët që bëjnë thirrje mund të përdorin edhe informacion tjetër (p.sh. informacion i dhënë me SMS).

Operatorët e shërbimeve telefonike do të kenë obligimin të sigurojnë një shërbim për klientin duke dhënë informacion të lidhur me portabilitetin 24/24, 7/7.

**LISTA E RAPORTEVE STANDARDE****1) RAPORTE STATISTIKORE****I. RAPORTE STATISTIKORE LIDHUR ME:**

- a. Numrin total te kërkesave për bartje të dërguara tek DBRC te pranuar ose refuzuara (për çdo OM);
- b. Numrin e kërkesave për bartje te anuluar (për çdo OM ose ODh)
- c. Numrin e kërkesave për bartje te refuzuara nga OfDBRC ose ODh (për çdo OM);
- d. Numrin e kërkesave të ndërprera (për çdo OM)
- e. Numrin e kërkesave për numrin e bartur të shkëputura (për çdo OM)
- f. Numrin e kërkesave për ndryshim të informacionit bazë (për çdo OM)

**II. RAPORTE STATISTIKORE TË PËRGJITHSHME LIDHUR ME:**

- a. Numrin e numrave gjeografik të bartur (për çdo OM);
- b. Numrin e numrave jo gjeografik të bartur, bashkë me ato për shërbimet telefonike të lëvizshme (për çdo OM);
- c. Numrin e numrave jo gjeografik të bartur për shërbimet telefonike të lëvizshme (për çdo OM);
- d. Numrin total të numrave që kanë marrë bartje (për çdo OM)
- e. Numrin total të numrave të transferuara ndërmjet bartjes (për çdo ODh);
- f. Numrat e shkëputur dhe transferuar tek ODhF-ja (për çdo OM);

**2) RAPORTET E ECURISË SË PROCESIT TË BARTJES**

- a. Raportet mbi afatet e tejkaluar (për çdo OM ose ODh)
- b. Raportet mbi listën e mesazheve (që lejojnë monitorimin e historisë të lëvizjes, bazuar në listën e mesazheve të shkëmbyera gjatë procesit respektiv);
- c. Raportet mbi kohën mesatare të procesimit në prezantimin e informacionit ndërmjet fazave të ndryshme;
- d. Raporte mbi parametrat e monitoruara të cilësisë së procesit të bartjes;

**3) RAPORTE MBI FUNKSIONIMIN E DBRC, LIDHUR ME**

- a. Kohën totale kur DBRC nuk funksiononte
- b. Periudhat e planifikuara të ndërprerjeve gjatë vitit;
- c. Periudhat jo të planifikuara të ndërprerjeve gjatë vitit;
- d. Koha mesatare për rifillimin e funksionimit të DBRC-së pas ndërprerjes së pa planifikuar
- e. Zgjatja totale kur DBRC nuk funksiononte, gjatë programit të punës së rregullt.
- f. Zgjatja totale kur linket e komunikimit nuk funksionin;
- g. Ankimet e përdoruesve në lidhje me funksionimin e DBRC dhe mënyra për zgjidhjes së këtyre ankimeve.

**4) RAPORTE NË LIDHJE ME DETEKTIMIN E PËRPJEKJEVE PËR AKSES TE PAAUTORIZUAR.**